


Programi i Bashkimit Evropian "Përkrahja e Shoqërisë Civile"
për organizatat e shoqërisë civile



VLERËSIM I INTEGRITETIT POLICOR NË SHQIPËRI



Ky raport është mbështetur
nga Bashkimi Evropian

POINTPULSE 
WESTERN BALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST

**VLERËSIM I
INTEGRITETIT
POLICOR NË
SHQIPËRI**

VLERËSIM I INTEGRITETIT POLICOR NË SHQIPËRI

Botuesit

Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim
Rruga Shenasi Dishnica, 1, Tirana, Albania
Tel: +355 4 240 0241
Email: info@idmalbania.org
www.idmalbania.org
www.pointpulse.net

Autorë

Besjana Kuçi, Eranda Begaj

Redaktor

Arijan Dyrmishi

Dizajni dhe faqosja

DTP Studio

Rreth raporti

Ky raport botohet si pjesë e aktivitetit “Pulsi i Integritetit dhe Besueshmërisë në Polici në Ballkanin Perëndimor: POINTPULSE”. Ky aktivitet mbështetet nga Bashkimi Evropian përmes programit “Përkrahja e Shoqërisë Civile” në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-Anëtarësimin (IPA). Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë vetëm të QInstituti për Demokraci e Ndërmjetësim dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian.

Rreth POINTPULSE

Qëllimi i POINTPULSE është të kontribuojë për rritjen e besimit në agjencitë e zbatimit të ligjit në Ballkanin Perëndimor duke promovuar integritetin policor. Anëtarë të POINTPULSE janë shtatë organizata të shoqërisë civile: Analytica, Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Qendra për Studime të Sigurisë, Instituti Alternativa, Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë.

Tirana 2016

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE	7
LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE	8
PËRMBLEDHJE.....	9
MBIKËQYRJA E JASHTME.....	12
Kuvendi	12
Dispozitat ligjore për mbikëqyrjen parlamentare	12
Organet e specializuara të mbikëqyrjes	18
Avokati i Popullit	18
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit	21
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).....	26
Kordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK)	29
Rekomandime	30
PËRGJEGJSHMËRIA E BRENDSHME	32
Kontrolli i Brendshëm.....	32
Trajtimi i ankesave ndaj policisë	34
Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat	34
Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP)	34
Rekomandime	38
MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	40
Planifikimi i burimeve njerëzore	40
Rekrutimet	41
Vlerësimi i Performancës dhe Ngritja në Detyrë	42
Trajnimi i vazhdueshëm.....	42
Rekomandime	44
MENAXHIMI FINANCIAR.....	46
Planifikimi i Buxhetit.....	46
Ekzekutimi i Buxhetit.....	47
Shpërdorimi i Prokurimeve Publike	51
Auditi i Brendshëm	51
Auditi i Jashtëm.....	52
Rekomandimet.....	54

NDJEKJA PENALE.....	55
Niveli i Ndëshkueshmërisë.....	57
Rekomandimet.....	57
REFERENCAT	59

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BKH	Byroja Kombëtare e Hetimit
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DSP	Drejtoria e Standardeve Profesionale
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
KÇLAPDNJ	Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
KEF	Komisioni për Ekonominë dhe Financat
KEI	Komisioni për Integrimin Evropian
KKK	Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KSK	Komisioni për Sigurinë Kombëtare
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
PSH	Policia e Shtetit
PT	Programi i Transparencës
SHÇBA	Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

Tabela 1	Monitorimi i Programit të Transparencës 2016
Tabela 2	Zbatimi i masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNKK për të cilat PSH është përgjegjëse
Tabela 3	Masat disiplinore të rekomanduara sipas strukturës specifike; Periudha 1 janar – 6 shtator 2016
Tabela 4	Numri i masave disiplinore të dhëna nga Drejtoria e Standardeve Profesionale 1 janar - 6 shtator 2016
Tabela 5	Masat disiplinore të rekomanduara sipas strukturës, Periudha: 1 janar - 6 shtator 2016
Tabela 6	Masat disiplinore sipas gradave
Tabela 7	Trajnimet e kryera nga muaji prill 2016 to shtator 2016 sipas drejtorisë së përgjithshme dhe strukturave të tjera
Grafik 1	Ankesat ndaj zyrtarëve të Policisë së Shtetit të paraqitura tek Avokati i Popullit gjatë periudhës 2012-2015
Grafik 2	Veprimet e Gjykatës së Shkallës së Parë



PËRMBLEDHJE

Miratimi i paketës për reformën në drejtësi në korrik të vitit 2016 përbën hapin e parë konkret në drejtim të forcimit të shtetit ligjor dhe progresit në rrugën drejt familjes evropiane. Është e kuptueshme se reforma në gjyqësor konsiderohet si një prej zgjidhjeve në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet. Megjithatë, përvoja në Shqipëri ka dëshmuar se miratimi i legjislacionit jo gjithmonë përputhet me zbatimin e tij dhe po ashtu as vullneti politik nuk përkon gjithmonë me angazhimin e nevojshëm për të përmirësuar status quo-në. Prandaj, fokusi tek reformat në drejtësi duket sikur ka lënë në hije problemet që lidhen me integritetin e policisë.

Korrupsioni është ende mjaft i përhapur në shumë fusha, pavarësisht masave anti-korrupsion në fuqi. Në këtë aspekt, ky raport ka si qëllim të bëjë një vlerësim të integritetit policor dhe të shqyrtojë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë dhe të përgjegjshmërisë. Gjatë këtij viti, integriteti policor u komprometua nga problemet e rryshfetit dhe shpërdorimit të detyrës, përdorimit të tepruar të forcës, sjelljes pasive profesionale dhe akuzave për lidhje me trafikun e drogës. Kësisoj, integriteti policor duhet të kthehet në një nga fushat prioritare të zhvillimit të mëtejshëm strategjik të këtij shërbimi. Është ngritur tashmë një sistem kompleks për kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të Policisë së Shtetit (SP), sistem që karakterizohet nga bashkëpunimi dhe shkëmbim i pamjaftueshëm i informacionit mes autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen si dhe nga zbatimi i dobët i përfundimeve dhe rekomandimeve të tyre. Për më tepër, qytetarët në përgjithësi janë të paqartë për sa i përket kanaleve dhe autoriteteve përkatëse ku duhet të raportojnë korrupsionin apo sjelljet e pahijshme, konfuzion ky që rezulton nga prania e një numri tepër të madh aktorësh. Edhe pse është arritur progres, kryesisht në lidhje me miratimin e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, autoritetet mbikëqyrëse nuk kanë arritur ende efikasitetin e duhur për zbatimin e kompetencave të tyre.

Që nga viti 2014 Policia e Shtetit ka një ligj të ri, i cili u pasua nga miratimi i një pakete ligjore përfshirë këtu edhe Rregulloren e re e të Policisë së Shtetit (në 2015), Strategjinë për Rendin Publik 2015-2020 dhe Planin e Veprimit 2015-2017, të cilat ofrojnë garancitë ligjore për parandalimin e korrupsionit brenda Policisë së Shtetit. Për më tepër, Ligji për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, i miratuar në vitin 2014, shfuqizoi ligjin e mëparshëm për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm. Ky ligj parashikon dispozita të qarta sa i përket luftës kundër korrupsionit në polici.

Në këtë kontekst, ky raport shqyrton nivelin e integritetit institucional të Policisë së Shtetit, bazuar në analizën e punës dhe rezultatet e të gjithë aktorëve përgjegjës për kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm të punës së policisë për periudhën kohore nga



viti 2015 deri në 2016. Janë marrë në analizë pesë fusha: (1) mbikëqyrja e jashtme, (2) Përgjegjshmëria e brendshme, (3) Menaxhimi i burimeve njerëzore, (4) Menaxhimi financiar, dhe (5) Ndjekja penale. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë iu kushtua katër fazave të ciklit të integritetit: angazhimi politik, zbatimi, monitorimi dhe raportimi. Në secilin kapitull jepen rekomandime për përmirësimet që nevojiten për fushën në fjalë. Në përgjithësi ky raport ka për qëllim të kontribuojë në përmirësimin e funksionimit të PSH-së dhe mbikëqyrjen e punës së saj për rendin. Për këtë raport u përdor një qasje cilësore. Shqyrtimi i raporteve më të rëndësishme dhe të dokumenteve dhe kornizës ligjore dhe të politikave u plotësua me të dhënat parësore të përfituara nga intervistat gjysmë të strukturuar dhe intervistat grup të kryera me informatorët kyç nga institucionet përkatëse publike.

Ky raport evidenton pesë gjetje kryesore:

1. Edhe pse janë bërë hapa përpara për hapjen e Parlamentit ndaj publikut, mekanizmat e kontrollit lidhur me punën e policisë zbatohen në mënyrë sporadike dhe ndikimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve të komisioneve të Kuvendit është ende i dobët. Mbikëqyrja nga Kuvendi përcaktohet në ligjet organike të institucioneve kryesore të sigurisë, por ka ende nevojë për ndryshime dhe qartësim të dispozitave në këtë drejtim. Për shkak të polarizimit të lartë politik dhe burimeve të kufizuara njerëzore, mbikëqyrja nga Kuvendi mbetet një hallkë e dobët e mbikëqyrjes së policisë. Organet e tjera mbikëqyrëse të pavarura vuajnë përgjithësisht nga burime dhe personel të pamjaftueshëm dhe në disa raste nuk kanë ekspertizën e nevojshme për kontrollin demokratik mbi policinë. Kjo bëhet më e qartë kur atyre u transferohen përgjegjësi të reja pa mbështetjen përkatëse financiare.
2. Kuadri institucional për kontrollin e punës së policisë është hartuar dhe tashmë është pothuajse i plotë. Megjithatë, ka ende shumë vend për të prezantuar mekanizma të tjerë për të siguruar zbatimin e masave parandaluese dhe ndëshkuese që ndihmojnë në rritjen e nivelit të integritetit të policisë.
3. Janë marrë masat të rëndësishme me qëllim trajtimin e problemit të korrupsionit në Policinë e Shtetit. Disa nga masat që lidhen me transparencën publike dhe përmirësimin e shërbimeve policore janë edhe hapja e zyrave me një ndalesë në komisariatet e policisë, instalimi i kamerave tek patrullat e policisë dhe kamerave në trup për sektorin e policisë rrugore për të ulur korrupsionin e vogël, si dhe prezantimi i formave të reja për raportimin e korrupsionit dhe ankesave ndaj policisë nga ana e qytetarëve. Megjithatë, nuk është hartuar ende një strategji afatgjate për menaxhimin e burimeve njerëzore të Policisë të Shtetit, për shkak të ndryshimeve të fundit organizative që kanë ndodhur në këtë institucion. Nga ana tjetër, Minist-



ria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Policia e Shtetit duhet të përditësojnë edhe më tej të dhënat dhe informacionin publik për veprimtarinë e policisë, duke mos u kufizuar vetëm në miratimin e kuadrit ligjor, por të publikojnë edhe zbatimin e këtij kuadri.

4. Është e rëndësishme të rritet transparenca në lidhje me gjendjen e menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe auditimit të brendshëm në sektorin e Policisë së Shtetit. Ekzekutimi i buxhetit dëmtohet nga performanca e ulët e investimeve, duke bërë kështu të nevojshme përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit si dhe zbatimin në kohë të procedurave të prokurimit. Stafi i auditit të brendshëm nuk ka kapacitete, nismat e auditimit nuk vlerësojnë rrezikun në sistem dhe auditet e kryera nga njësitë e auditit të brendshëm të Policisë së Shtetit bëhen për transaksione të caktuara dhe jo për të gjithë sistemin. Ka ende mbivendosje të përgjegjësive mes sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe duplikime të shërbimeve të auditimit të brendshëm mes institucioneve eprore dhe atyre vartëse.
5. Nuk janë bërë publike rezultatet sa i përket ndjekjes penale për korrupsionin e nivelit të lartë në polici dhe për ndjekjen e mëtejshme të tyre në nivelet më të larta gjyqësore. Larmia e burimeve të informacionit mund të nxisë hetimet për korrupsion duke nxjerrë kështu më në pah rolin kyç që luan koordinimi i të gjithëve aktorëve. Numri i përgjithshëm i rasteve të shqyrtuara nga gjykatat e shkallës së parë për periudhën 2014-2016 është: 61 punonjës, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë – shpallur fajtor dhe dënuar; 22 punonjës, në proces gjyqësor në Gjykatën e Shkallës së Parë.



MBIKËQYRJA E JASHTME

Në këtë seksion do të trajtohen institucionet që janë të pavarura nga policia si nga ana organizative ashtu edhe ajo operacionale (Kuvendi, organet e specializuara të mbikëqyrjes përfshirë këtu edhe shoqërinë civile dhe median), të cilat kanë mandatin për të monitoruar dhe mbikëqyrur integritetin policor. Në përmbushjen e mandatit të tyre, këtyre institucioneve u duhet të përballen me një nivel të lartë politizimi dhe në përgjithësi kanë mangësi në personel dhe burime. Po ashtu, ato nuk kanë ekspertizën e nevojshme për bërë të mundur kontrollin demokratik mbi policinë

Kuvendi

Dispozitat ligjore për mbikëqyrjen parlamentare

Në dy vitet e fundit, veprimtaria e Kuvendit është fokusuar kryesisht në paketën e reformës në drejtësi dhe në ndryshimet kushtetuese të miratuara në korrik të vitit 2016. Çështjet e dekriminalizimit dhe integritetit të funksionarëve që ushtrojnë detyra publike ishin po ashtu në plan të parë të punës së Kuvendit. Ky proces u nxit nga asistencë intensive e komunitetit ndërkombëtar.

Për qëllim të këtij raporti, kontrolli dhe mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë rregullohen nga Kushtetuta¹ dhe Rregullorja e Brendshme e Kuvendit². Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton se Kuvendi është organi më i lartë që kontrollon buxhetin e institucioneve shtetërore, duke u bërë kështu një mekanizëm kyç në kontrollin financiar për sa i përket procesit të përgatitjes së projekt buxheteve të institucioneve të sektorit të sigurisë si dhe në fazën e kontrollit të shpenzimeve dhe realizimit të buxhetit.

Mbikëqyrja e sektorit të sigurisë bën pjesë kryesisht në kompetencat e Komisionit për Sigurinë Kombëtare (KPS), Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KÇLAPÇDN), Komisionit për Ekonominë dhe Financat

1 Neni 80, Kushtetuta e Shqipërisë. "Drejtesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji."

2 Vendimi Nr. 95/2014, datë 27.11.2014 "Rregullorja e Brendshme e Kuvendit", i ndryshuar.



(KEF) dhe Komisionit për Integrimin Evropiane (KIE).³ Komisioni për Sigurinë Kombëtare (KPS) është përgjegjëse për vlerësimin, shqyrtimin, analizimin e çdo aspekti në lidhje me sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes në Shqipëri. Kompetencat e këtij komisioni janë organizimi i mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimi ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendi publik dhe shërbimet sekrete. Kështu, Komisioni për Sigurinë Kombëtare është organi kryesor parlamentar përgjegjës edhe për kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së Policisë së Shtetit.

Edhe pse mbikëqyrja parlamentare parashikohet në ligjet kryesore të institucioneve kryesore të sigurisë, ka ende nevojë për ndryshime dhe dispozita të qarta në këtë drejtim. Lidhur me këtë, Ligji për Policinë e Shtetit nuk parashikon një rol të qartë për Parlamentin. Megjithatë, Ministria e Punëve të Brendshme është organi përgjegjës që i raporton Kuvendit dhe Komisionit për Sigurinë Kombëtare në lidhje me veprimtarinë e Policisë së Shtetit. Mbikëqyrja e kësaj të fundit sigurohet përmes instrumenteve parlamentare, të tilla si seanca plenare dhe interpelanca me Ministrin e Brendshëm, seanca dëgjimore me Drejtorin e Policisë dhe ngritjen e komisioneve hetimore.

Me qëllim përmbushjen e mandatit të tyre të mbikëqyrjes së sektorit të sigurisë, komisionet kanë të drejtë të thërrasin në çdo kohë ministrat për të dhënë shpjegime dhe sqarime për probleme të fushave ku ata janë individualisht përgjegjës si dhe për zbatimin e ligjeve, të vendimeve, rezolutave ose deklaratave të miratuara nga Kuvendi. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve, japin shpjegime dhe informojnë për çështje që lidhen me veprimtarinë e tyre. Për më tepër, komisionet e përhershme, brenda fushave përkatëse të përgjegjësisë, mund të kryejnë kontrolle ose të kërkojnë dokumentacione që i konsiderojnë të nevojshme për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar. Në përfundim të kontrollit, komisionet hartojnë një raport, i cili i përcillet Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet i njohur publikisht, duke përfshirë edhe mendimin e pakicës.⁴

Po ashtu, komisioni përgjegjës për institucionet e sektorit të sigurisë mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara gjatë procesit legjislativ.⁵

3 Neni 18, Kompetencat e komisioneve të përhershme, Vendimi Nr. 95/2014, datë 27.11.2014 "Rregullorja e Brendshme e Kuvendit", i ndryshuar. "Komisionet e përhershme të Kuvendit shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore, duke i propozuar Kuvendit ose Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta."

4 Neni 102 Kontrolli nga komisionet e përhershme të Kuvendit, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit.

5 Neni 36 Seancat dëgjimore publike, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit.



Në përbërje të komisioneve të përhershme, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen edhe nënkomisione për probleme të veçanta.⁶ Për më tepër, dispozitat e përcaktuara në rregulloren e brendshme parashikojnë përdorimin nga ana e deputetëve të pyetjeve, interpelancave dhe mocioneve si instrumente të përshtatshme për kontrollin dhe mbikëqyrjen e institucioneve.⁷

Në aspektin e kontrollit buxhetor të institucioneve të sektorit të sigurisë, Komisioni për Sigurinë Kombëtare bashkëpunon ngushtësisht me Komisionin për Ekonominë dhe Financat. Këto komisione shqyrtojnë shpenzimet dhe parashikimet buxhetore që realizohen nga ministrinë përkatëse. Gjithashtu, ato diskutojnë dhe vlerësojnë çdo kërkesë shtesë, çdo ndryshim në zërin e shpenzimeve që mund të bëhet në buxhet. Ministri duhet të jetë në gjendje të mbështesë projektbuxhetin duke dhënë sqarime për çdo detaj dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të gjithanshme që mund të bëhen nga anëtarët e opozitës. Komisioni për Sigurinë Kombëtare rekomandon ndryshimet në buxhet, të cilat i dërgohen Komisionit për Ekonominë dhe Financat që bën pjesën më të madhe të punës në lidhje me buxhetin.⁸ Pavarësisht rolit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, në ushtrimin e detyrave të tij të mbikëqyrjes përmes buxhetimit, autoriteti i tij duket se minohet për shkak të ndikimeve dhe përkatësive politike. Në vitin e kaluar, kundërshtimet dhe kërkesat e opozitës nuk u morën parasysh për shkak të përdorimit të forcës së kartonit nga deputetët e shumicës.

Projektligji për mbikëqyrjen parlamentare të institucioneve të inteligjencës dhe sigurisë hartuar që në vitin 2013 është harruar tashmë. Në atë kohë, ky projektligj synonte veçanërisht sigurimin dhe mbikëqyrjen efektive të kuadrit dhe veprimtarisë ligjore, shpenzimeve financiare dhe buxhetit të institucioneve të sektorit të sigurisë si dhe kontrollin demokratik mbi ekzekutivin.

Në parim, rregulloret aktuale të Kuvendit mundësojnë një nivel të caktuar të mbikëqyrjes policore. Megjithatë, dispozitat e paqarta ligjore dhe konfigurimi kompleks institucional i japin ekzekutivit liri të madhe veprimi, duke penguar kështu kontrollin dhe mbikëqyrjen efektive të Kuvendit mbi këtë veprimtari. Për më tepër, Ligji për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHÇBA) përcakton mbikëqyrjen e Parlamentit mbi veprimtarinë e tij ashtu si edhe disa institucioneve të tjera.⁹

6 Neni 19, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit.

7 Neni 89, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit.

8 Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë nëpërmjet Buxhetimit, 2011, http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/PARLIAMENTARY-OVERSIGHT-OF-THE-SECURITY-SECTOR-THROUGH-BUDGETING_June-2011.pdf.

9 Neni 23. Ligji Nr. 70/2014 "Për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave".



Rregullorja e brendshme i jep opozitës mundësinë të krijojë komisione hetimore. Për sa i përket mbikëqyrjes policore për periudhën 2014-2016, me kërkesën e grupit të opozitës janë ngritur tre komisione hetimore. Komisioni hetimor për shkarkimin e stafit në Policinë e Shtetit u krijua në shkurt të vitit 2014, por ai nuk arriti të dalë me ndonjë rezultat konkret apo rekomandime politikash për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së vendimeve të karrierës në Policinë e Shtetit¹⁰. Megjithatë, nga analiza e provave për emërimet dhe shkarkimet në Policinë e Shtetit evidentohet se niveli i lirisë së veprimit për ekzekutivin është më i lartë në rastin e këtij institucioni.¹¹ Si rregull, zëvendësimet në Policinë e Shtetit kanë ndodhur pas ndërrimit të qeverisë, siç është rasti në vitin 2013. Organet përgjegjëse për emërimet e nivelit të lartë në Policinë e Shtetit, qoftë drejtor dhe zëvendës drejtor i Policisë së Shtetit janë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Këshilli i Ministrave që miraton propozimin e Ministrit të Punëve të Brendshme.

Një tjetër komision hetimor që vazhdon ende punën është ai i ngritur për të trajtuar rastin e pajisjes elektronike “IMS I Catcher” në Policinë e Shtetit, që pretendohet se është përdorur për të përgjuar komunikimet në mënyrë të paligjshme.

Roli i Parlamentit në përgjithësi ka qenë i dobët në drejtim të ndikimit për ndryshimin e politikave apo për rritjen e transparencës në funksionimin e mekanizmave të kërkesës së llogarisë brenda Policisë.

Për sa i përket rregullores, veprimtaria parlamentare mbështetet nga shërbimet e Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit kryejnë detyra këshillimore, informuese organizative dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij. Shërbimet e Kuvendit krijojnë mundësi dhe kushte të barabarta që deputetët, Kuvendi dhe organet e tij të kryejnë detyrat kushtetuese dhe ligjore. Në këto shërbime përfshihen: shërbimet legjislative, në përbërje të cilave janë shërbimi i seancës plenare, shërbimi juridik, shërbimi i analizës dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe shërbimi i komisioneve të Kuvendit.¹² Po ashtu, komisionet mund të angazhojnë me kohë të pjesshme specialistë të fushave të ndryshme.¹³

Pavarësisht kësaj dispozite, bazuar në informacionet e dhëna për këtë raport, Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka mangësi në staf. Aktiviteti i tij bazohet kryesisht në

10 Transparency International “Sistemi Kombëtar i Integritetit (National Integrity System) (NIS)”, 2016, f. 122.

11 Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, 2014. http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/01/monitoring_and_evaluation_of_security_sector_governance_in_albania_2014.pdf, f. 42.

12 Neni 120, Shërbimet e Kuvendit, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit.

13 Neni 41, Aktivizimi i specialistëve të jashtëm, Rregullorja e Brendshme e Kuvendit.



mbështetjen e ofruar nga shërbimet legislative. Për më tepër, Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë theksoi se kapacitetet kërkimore dhe analitike mbeten të kufizuara.¹⁴ Në vitin 2016, nuk ka të dhëna zyrtare për angazhimin e ekspertëve për çështje të integritetit të policisë. Gjithashtu, raporti vjetor i hartuar nga Kuvendi nuk jep hollësi për burimet njerëzore të secilit komision parlamentar.

Në aspektin e transparencës së veprimtarisë parlamentare, Kuvendi ka përditësuar faqen e tij të internetit ku përgjithësisht ka informacion të rifreskuar për veprimtarinë e tij. Që nga vitit 2013 Kuvendi ka publikuar tri raporte vjetore për veprimtarinë e tij. Nuk ka raporte parlamentare të publikuara para kësaj periudhe. Megjithatë, raportet vjetore parlamentare mund të pasuroheshin më tej me informacione specifike për burimet administrative dhe njerëzore në dispozicion të deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij. Rritja e transparencës së punës së Kuvendit është theksuar edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016. Sipas këtij raporti, nevojitet më shumë transparencë për punën e komisioneve të Kuvendit. Këto të fundit kanë vazhduar konsultimet me aktorët kryesorë¹⁵, por është e nevojshme të bëhen përmirësime për njoftimin paraprakë dhe punën në vazhdim.¹⁶

Për më tepër, në krahasim me rajonin e Ballkanit raporti në Indeksin e Hapjes së Parlamentit 2016 e rendit Kuvendin e Shqipërisë të katërtin pas Malit të Zi, Serbisë dhe Kroacisë.¹⁷ Kategoritë e vlerësuara për këtë indeks janë: transparenca e informacionit parlamentar, promovimi i kulturës së hapjes parlamentare dhe aksesin në informacionin parlamentar.

Procesverbalet e takimeve dhe diskutimeve në seancë plenare të komisioneve i vihen në dispozicion publikut në faqen e internetit të Kuvendit. Sipas rregullores, veprimtaria parlamentare transmetohet nga Televizioni Publik Shqiptar. Po ashtu, është krijuar edhe faqja ku punimet e Kuvendit mund të ndiqen drejtpërsëdrejti në faqen e internetit.

Për sa i përket vlerësimit të mbikëqyrjes policore, në vitin 2015, Komisioni për Sigurinë Kombëtare mbajti vetëm dy seanca dëgjimore me Ministrin e Punëve të Brendshme për angazhimin e strukturave të Policisë së Shtetit në ngjarjet e Lazaratit, ku u

14 Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

15 Ligji Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

16 Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

17 Indeksi i Hapjes së Parlamentit 2016 – Serbia dhe rajoni: <http://crta.rs/wp-content/uploads/2016/09/PARLIAMENTARYOPENNESSINDEX-1.pdf>.



vra një oficer policie dhe u plagosën dy të tjerë¹⁸ si dhe një seancë tjetër dëgjimore për masat në luftën kundër terrorizmit

Në vitin 2016, Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut mbajti seanca dëgjimore me Ministrin e Punëve të Brendshme për Projektligjin “Për kontrollin kufitar”¹⁹ dhe Projektligjin “Për masa të tjera shtesë për rendin publik”²⁰. Për më tepër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare organizoi seancë dëgjimore edhe me Drejtorin e Policisë së Shtetit dhe Ministrin e Punëve të Brendshme në lidhje me akuzat për pajisjen elektronike “IMSI Catcher” në Policinë e Shtetit, që pretendohet se është përdorur për të përgjuar komunikimin në mënyrë të paligjshme.

21

Pas këtyre diskutimeve, me kërkesën e deputetëve të Partisë Demokratike, Kuvendi ngriti një komision hetimor me mandatin për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit për përdorimin dhe administrimin e pajisjes “IMSI Cathcer” nga strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit për përgjime të paligjshme.²² Deri tani, ky komision është mbledhur vetëm një herë në mënyrë formale. *Për më tepër për këtë çështje lexoni më poshtë.*²³ Siç thekson edhe Raporti i Progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, puna e këtij komisioni ishte tejet konfliktuale dhe nuk doli me rezultate konkrete.²⁴ Nga ana tjetër, përdorimi i mekanizmave të tjerë të mbikëqyrjes së policisë është ende i ulët. Gjatë viteve 2015 dhe 2016, diskutimet për reformën gjyqësore, miratimi i akteve nënligjore për Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH)²⁵ dhe ligji i vetingut ishin shumë të politizuara. Byroja Kombëtare e Hetimeve ka si aktivitet kryesor të saj zbulimin dhe hetimin e aktiviteteve dhe veprave penale që lidhen me

18 Portal online Shqiptarja.com: Vritet efektiv i RENEA-s në Lazarat “Grupi i zjarrit” me 21 persona, <http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/vritet-efektiv-i-renea-s-ne-lazarat---grupi-i-zjarrit-me-21-persona-300972.html>.

19 Procesverbal i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut 31.05.2016, <https://www.parlament.al/komisioni-per-ceshtjet-ligjore-administraten-publike-dhe-te-drejtat-e-njeriut-shqyrton-projektligjin-per-kontrollin-kufitar/>.

20 Projektligj “Për masa të tjera shtesë për rendin publik” Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, datë 26.01.2016.

21 Procesverbal i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, datë 18.05.2016, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/06/Komisioni-i-Siguris---dat---18-05-2016.pdf>.

22 Vendimi i Kuvendit Nr. 66/2016, datë 6.10.2016.

23 Në qershor të vitit 2016 Drejtori i Policisë së Shtetit u pezullua me kërkesë të prokurorëve të cilët po e hetonin atë për shpërdorim detyre në lidhje me dyshimin se policia në mënyrë të paligjshme kishte përdorur një pajisje përgjimi, e cila, thonë prokurorët, ka hyrë në vend “pa autorizimin e duhur”. Hetimet kanë nisur për të sqaruar dyshimet në lidhje me pajisjet elektronike në drejtorinë e policisë, të cilat presidenti dhe opozita kanë pretenduar janë përdorur për përgjimet. Me vendim të Gjykatës së Apelit në korrik 2016, Drejtori i Policisë së Shtetit u rikthye në detyrë.

24 Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

25 Ligji Nr. 108/2014, datë 31.7.2014, ‘Për Policinë e Shtetit.



korrupsionin.²⁶ Megjithatë, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi krijimin e kësaj byroje me arsyetimin se kjo byro bie në kundërshtim me Kushtetutën.²⁷

Shumica në pushtet pretendon se opozita po bllokoi reformat e qeverisë. Pingpongu parlamentar është mjaft i njohur për ligjet që shkojnë e vijnë me radhë dhe kalojnë sa nga njëra parti politike tek tjetra në kampin kundërshtar.

Në nëntor të vitit 2016, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrtoi dhe miratoi në parim projekt buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2017 të prezantuar nga Ministri përkatës. Buxheti i kësaj ministrie ka një pjesë të veçantë për Policinë e Shtetit dhe Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Në buxhetin e ri propozohen rritje pagash për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe investime për institucionin e policisë. Aktualisht nuk ka raporte specifike për çështjet që lidhen me integritetin e policisë. Puna e komisionit hetimor është ende në vazhdim e sipër.

Organet e specializuara të mbikëqyrjes

Organet e pavarura të mbikëqyrjes luajnë një rol shumë të rëndësishëm për qeverisjen demokratike të institucioneve të sektorit të sigurisë. Për qëllime të këtij raporti, institucionet pavarura të analizuar këtu janë: Avokati i Popullit (AP), Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) – Shih kreun e Menaxhimit Financiar, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Koordinatorin Kombëtar Kundër Korrupsionit (KKK).

Avokati i Popullit

Sipas Kushtetutës, “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.”²⁸ Përveç mandatit të parashikuar në Kushtetutë dhe në ligjin organik,²⁹ Avokati i Popullit përgjigjet edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtat dhe Trajtimin e të Ndaluarve³⁰ dhe vepron si Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Ndëshkimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar.³¹

26 Ligji për Policinë e Shtetit, 2014, Neni 27.

27 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr. datë 26.06.2015.

28 Kushtetuta e Shqipërisë, Pjesa II, Kreu VI, Neni 60.

29 Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999, plotësuar nga Ligji Nr. 8600, datë 10.04.2000, ndryshuar nga Ligji Nr. 9398, datë 12.05.2005, dhe plotësuar e ndryshuar nga Ligji Nr. 155/2014, datë 27.11.2014, “Për Avokatin e Popullit”.

30 Ligji Nr. 9888, datë 10.3.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të ndaluarve”, i ndryshuar.

31 Ligji Nr. 155/2014, datë 27.11.2014, “Për Avokatin e Popullit”, Neni 31/1.



Pavarësia në ushtrimin e detyrave të tij është parashikuar në Kushtetutë. Avokati i Popullit zgjidhet nga Kuvendi me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Ai mund të shkarkohet nga detyra vetëm nga Kuvendi me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij me kërkesë të motivuar të parashtruar nga jo më pak se një e treta e anëtarëve të tij.³² Për të siguruar pavarësinë e plotë, Avokati i Popullit ka buxhetin e vet që miratohet nga Kuvendi.³³ Avokati i Popullit i paraqet Kuvendit raporte vjetore që i vihen në dispozicion të publikut. Siç përcaktohet me ligj, Avokati i Popullit ka të drejtë:

1. t'u rekomandojë organeve që kanë të drejtën ligjvënëse të bëjnë propozime për ndryshimin dhe përmirësimin e ligjeve;
2. t'u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive;
3. të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e akteve të tilla.³⁴

Avokati i Popullit mund t'i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. Ai ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij.³⁵

Ligji “Për Avokatin e Popullit” përcakton disa dispozita që mundësojnë mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë, përfshirë këtu edhe mbikëqyrjen e policisë. Së pari, ligji përcakton ngritjen e një seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor.³⁶ Seksioni kryesohet nga një prej pesë komisionerëve të zgjedhur nga Kuvendi. Numri total i këtij seksioni është pesë vetë. Së dyti, në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton; të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin; të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet. Së treti, në rast refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të

32 Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 62.

33 Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 60.

34 Neni 24.

35 Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 63.


36 Ligji Nr. 155/2014, datë 27.11.2014, “Për Avokatin e Popullit”, Neni 31.



kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil. Avokati i Popullit i rekomandon prokurorisë të fillojë hetime në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një veprë penale; ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara. Në raportet e vitit 2015, ka një përqendrim të madh tek përdorimi i tepërt i forcës dhe dhunës nga punonjës të policisë.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit trajton ankesat, kërkesat apo njoftimet për shkelje të të drejtave të njeriut, që lindin nga administrimi i pushtetit gjyqësor dhe nga zbatimi i vendimeve gjyqësore. Në përputhje me këtë dispozitë, në grafikun më poshtë tregohen ankesat ndaj zyrtarëve të Policisë së Shtetit, të paraqitura tek Avokati i Popullit gjatë periudhës 2012-2015.

Grafiku 1: Ankesat ndaj punonjësve të policisë të paraqitura tek Avokati i Popullit gjatë periudhës 2012-2015 Burimi: Raportet vjetore të Avokatit të Popullit, 2012, 2013, 2014, 2015³⁷



Në ankesat e paraqitura tek Avokati i Popullit përfshihen tortura dhe keqtrajtimi fizik dhe psikologjik gjatë arrestimit apo shoqërimit nga policia; ndalimet e paligjshme; kontrolli i paligjshëm i ambienteve të brendshme apo private; dhënia e masave të padrejta administrative, etj.³⁸

Pas këtyre ankesave, Avokati i Popullit ka paraqitur disa rekomandime tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Për të përmendur disa nga rekomandimet janë nevojë që të ketë një analizë të thellë të shkaqeve për këtë dukuri, përmirësimi i kurrikulave

37 Studimi "Integriteti dhe korrupsioni policor në Shqipëri 2.0" (2016), Institute për Demokraci dhe Ndërmjetësim, <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>, f. 42.

38 Raporti i Avokatit të Popullit 2015, f. 47.



të Akademisë së Policisë dhe Sigurisë me qëllim që punonjësit e policisë të njihen dhe të përqendrohen më shumë në respektimin e të drejtave të njeriut, trajnime më të shpeshta për etikën dhe qartësimet për të drejtat e punonjësve të policisë për të përdorur forcën në përputhje me dispozitat ligjore dhe me respektimin e parimit të proporcionalitetit, si dhe trajnime për legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

Për sa i përket trajtimit të mëtejshëm të rekomandimeve drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë: 6 rekomandime u pranuan, për 4 rekomandime nuk u dha përgjigje dhe për 2 të tjera u refuzua të merreshin parasysh.

Megjithatë, rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t'u provuar dhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, duke qenë se dhuna përdoret në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë.³⁹

Për më tepër, përdorimi i pajustificuar i dhunës konsiderohet si formë korrupsioni, sepse kryhet nga punonjës policie në pozicionin e tyre zyrtar. Në fakt, ky problem nuk zë ndonjë vend të rëndësishëm dhe as nuk raportohet në dokumentet e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave.⁴⁰ Në vitin 2015, Mekanizmi Kombëtar i Parandalimit të Dhunës dhe zyra e Avokatit të Popullit trajtuan 42 ankesa për përdorimin e tepruar të dhunës dhe forcës nga punonjës të policisë dhe rojet e burgjeve, nga të cilat për 10 raste u evidentua se ekzistonin prova të ligjshme.⁴¹

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit

Që nga krijimi i tij në vitin 2008 Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, (që këtu më poshtë do të quhet Komisionerit⁴²), i janë dhënë disa përgjegjësi të reja të mbikëqyrjes mbi entet publike dhe private.

Komisioneri zgjidhet nga Kuvendi⁴² me propozim të Këshillit të Ministrave. Ai ka një mandat pesë vjeçar me të drejtë rinovimi. Komisioneri është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave perso-

39 Raporti i Avokatit të Popullit 2015, f. 51.

40 Studimi "Integriteti dhe korrupsioni policor në Shqipëri 2.0" (2016), Institute për Demokraci dhe Ndërmjetësim, <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>, f. 42.

41 Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf, f. 36.

42 Vendimi i Kuvendit, Nr. 211, datë 11.09.2008 "Për Emërimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".



nale dhe të drejtën e informimit duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Parlamenti miraton buxhetin dhe strukturën administrative të këtij institucioni.

Komisioneri i paraqet raporte vjetore Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Përveç detyrës për të kontrolluar zbatimin e Ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”,⁴³ në dy vitet e fundit, mandati i Komisionerit është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme duke përfshirë edhe kontrollin e zbatimit të Ligjit “Për të drejtën e informimit”⁴⁴ dhe të Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”⁴⁵. Ky i fundit rregullon procesin e njoftimit dhe konsultimit publik të projektligjeve, projekt dokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik, përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike si dhe synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.⁴⁶ Roli i Komisionerit konsiston në trajtimin e ankesave dhe ndërmjetësimin me organet publike.

Për më tepër, sipas ligjit, Komisioneri ka të drejtë të kryejë hetimet e nevojshme administrative; të japë rekomandime, urdhra, vendime për kontrolluesit e të dhënave; ofron opinione për projekt ligjet dhe aktet nënligjore;⁴⁷ ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes; urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale.⁴⁸

Në përputhje me përgjegjësitë e reja, ligji për rendin publik përcakton se ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, përcaktojnë me udhëzim të përbashkët ngritjen dhe funksionimin e një regjistri, si bazë të dhënash qendrore apo vendore, në të cilin regjistrohen subjektet që, sipas këtij ligji, marrin masa shtesë të sigurisë publike.

Subjektet, të cilat instalojnë sistemin e kamerave apo pajisje elektronike të teknologjisë së lartë, detyrohen në çdo rast të njoftojnë dhe bëjnë transparente para Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

43 Ligji Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

44 Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, i ndryshuar.

45 Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Neni 21.

46 Shih: <http://idp.al/index.php/en/home/106-press-releases/291-law-no-146-2014-on-notification-and-public-consultation>

47 Neni 31/1, Ligji Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

48 Ligji Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” Neni 5 & 12. <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/09/ligj-nr.-19-dt.-22.9.2016.pdf>.



E fundit por jo për nga rëndësia, Komisionerit i janë caktuar me ligj disa detyra që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”⁴⁹ si dhe të Ligjit “Për Kontrollin Kufitar”⁵⁰.

Policia e Shtetit i nënshtrohet mbikëqyrjes së Komisionerit. Ligji parashikon që autoritetet publike kanë detyrimin të njoftojë për përpunimin e të dhënave në kuadër të aktiviteteve të parandalimit dhe ndëshkimit të krimit, në rastet e një vepre penale kundër rendit publik dhe shkelje të tjera në fushën e të drejtës penale, mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare. Megjithatë, veprimtaria e Komisionerit nuk mbulon gjerësisht çështjet që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e policisë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit.

Hetimet administrative ndaj strukturave të policisë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, i kanë filluesat që në vitin 2010 me dy rekomandimet e nxjerra për Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit dhe Komisarariatit të Policisë të Pikës Kufitare Rinas.⁵¹ Në vitet në vijim Komisioneri nuk ka kryer ndonjë hetim administrativ në polici.

Në vitin 2015, në lidhje me monitorimin e së drejtës për informim, Komisioneri ka trajtuar dy ankesa kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH). Të dy ankesa janë paraqitur nga Qendra Respublica. Komisioneri ka pranuar ankesën mbi pretendimin e “refuzimit për të dhënë informacion dhe kopje të dokumenteve zyrtare nga Policia e Shtetit lidhur me kërkesën për informacion mbi numrin e personave të përgjuara gjatë 01.01.2014-30.10.2014”⁵². Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioneri urdhëroi Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të rishikojë procedurat për informacionin e klasifikuar dhe të njoftonte kërkuuesin. Në rastin tjetër, pas hetimit administrativ, Komisioneri ka hedhur poshtë ankesën e Qendrës Respublica mbi bazën se Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit kishte dhënë një përgjigje për kërkesën për informacion.⁵³

Pjesë e detyrave të Komisionerit është edhe monitorimi i zbatimit në internet i Programit të Transparencës në institucionet publike. Gjatë vitit 2016, Komisioneri ka monitoruar ministritë e linjës, përfshirë këtu edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme që

49 Neni 16, Ligji Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; Ligji Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.

50 Kreu III Administrimi i të dhënave personale, Ligji Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”.

51 Shih: <http://www.idp.al/index.php/sq/hetimi-administrativ-mbrojtja-personale-te-dhena?id=130:rekomandime-inspektimi-2010&catid=80>.

52 Shih: http://www.idp.al/images/inspektimi_di/vendim_08_pol.pdf.

53 Shih: http://www.idp.al/images/inspektimi_di/vendim_38_dpp.pdf.



ka të bëjë me këtë raport.⁵⁴ Komisioneri nuk ka bërë Programin e Transparencës së Policisë së Shtetit, por në bazë të këtyre treguesve të dhënat publike në dispozicion ende nuk janë përditësuar ose nuk janë bërë ende të disponueshme. Megjithatë, detyrat e ministrit në lidhje me Policinë e Shtetit, mes të tjerash, përfshijnë edhe mbikëqyrjen e procesit të ankesave në Policinë e Shtetit dhe shqyrtimin e ankesave që bëhen ndaj Drejtorit të Policisë së Shtetit; përgatitjen dhe publikimin e një raporti vjetor për arritjen e objektivave nga Policia e Shtetit; mbikëqyrjen e menaxhimit të buxhetit të Policisë së Shtetit, në bazë të legjislacionit financiar në fuqi.⁵⁵

Kështu, tabela e mëposhtme paraqet treguesit që mungojnë apo që janë publikuar pjesërisht sipas Programit të Transparencës. Nga 17 parimet e këtij programi, vetëm 5 konsiderohen si të disponueshme.

Tabela 1: Monitorimi i Programit të Transparencës 2016

	Treguesi i Programit të Transparencës/ Ministria e Punëve të Brendshme	I padisponueshëm	Pjesërisht i disponueshëm
1.	Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik		x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin/vetëm organigrama)
2.	Tekstet e plota të konventave, ligjeve, akteve nënligjore, kodit të sjelljes, të çdo dokumenti të politikave, manualeve ose të ndonjë dokumenti tjetër në lidhje me kryerjen e funksioneve të autoritetit publik që ndikon në publikun e gjerë.		x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin)
3.	Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.		x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin, nuk disponohet në Programin e Transparencës)
4.	Të dhënat për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit në fuqi, struktura e pagave për punonjësit e tjerë si dhe përshkrimi i procedurave të zgjedhjes, kompetencave të funksionarëve të lartë dhe procedura e ndjekjes për marrjen e vendimeve.	x (nuk disponohet në Programin e Transparencës)	

54 Shih: http://www.idp.al/images/informacione/shtyp/New_folder/2016/qershorr/MONITORIM_MBI_HARTIMIN_E_PROGRAMIT_TË_TRANSPARENCËS.pdf.

55 Neni 7. Ligji Nr. 108/2014, datë 31.7.2014, "Për Policinë e Shtetit".



5.	Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që funksionojnë në autoritetin publik, përfshirë këtu planet strategjike të punës, raportet e auditit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo ente të tjera si dhe dokumentet me tregues performance të autoritetit publik	x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin)	
6.	Të dhënat për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin e ardhshëm financiar dhe vitet e mëparshme, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në rastet kur autoriteti publik është me vetë-financim nga pagesat e licencave apo çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga ana e subjekteve të tij, publikohen edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga ana e subjekteve të licencuara.	x	
7.	Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesioneve/partneritetit publik-privat, përkatësisht, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për Prokurimin Publik” dhe Ligjit Nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, të kryera në emër të autoritetit publik, duke përfshirë këtu: i) listën e kontratave të nënshkruara; ii) shumën e kontratës; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimi i shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacione për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe manuale e politika të ndryshme.	x (nuk disponohet në Programin e Transparencës)	
8.	Informacioni për shërbimet publike të ofruara për publikun, duke përfshirë edhe standardet për cilësinë e shërbimit		x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin)
9.	Çdo mekanizëm apo procedurë përmes të cilët palët e interesuara mund të paraqesin pikëpamjet ose të ndikojnë në ndonjë mënyrë në hartimin e ligjeve, politikave publike ose performancën e autoritetit publik;	x (nuk disponohet në Programin e Transparencës)	
10.	Një përshkrim i thjeshtë i sistemit të përdorur nga autoriteti publik për mbajtjen e të dhënave, llojet dhe format e dokumenteve dhe kategoritë e informacioneve që i vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë	x (nuk disponohet në Programin e Transparencës)	
11.	Informacione dhe dokumente që kërkohen më shpesh		x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin)



12.	Çdo informacion tjetër që vlerësohet si i nevojshëm nga autoriteti publik		x (Nuk është vendosur lidhja me informacionin)
-----	---------------------------------------------------------------------------	--	------------------------------------------------

Në vitin 2015, Komisioneri organizoi një seminar me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me temë mbledhjen, përpunimin, arkivimin dhe standardet e sigurisë së të dhënave personale të qytetarëve, gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit.⁵⁶ Gjatë vitit 2015, nuk u konsultua me Komisionerin Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kroacisë për bashkëpunimin policor”. Për më tepër dy projekte të rëndësishme lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale janë aplikacioni ueb “Komisariati Dixhital” dhe “Sistemi multifunksional i kamerave të trupit të patrullave të Policisë së Shtetit”.⁵⁷

Megjithatë është e rëndësishme të theksohet se institucioni i Komisionerit merret edhe me disa çështje të pazgjidhura, të tilla si burimet e pamjaftueshme financiare dhe njerëzore për të mbuluar në të gjithë vendin detyra të reja të caktuara me ligji, nevoja për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për veprimtarinë e Komisionerit; prezantimi dhe përditësimi i teknologjive të reja, si dhe rritja e monitorimit dhe veprimtarisë së hetimit administrativ. Këto sfida u paraqitën nga Komisioneri në seancën dëgjimore për projektbuxhetin e vitit 2017 në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut⁵⁸. Në të njëjtën linjë me këto shqetësime është edhe rekomandimi i Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2016 ku theksohet nevoja e rritjes së kapaciteteve të Komisionerit për të realizuar detyrat në mënyrë sa më efektive.

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) luan një rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Inspektorati është autoriteti kryesor që pritet të kontrollojë dhe të japë udhëzime për çështjet e deklarimit të pasurive, konfliktit të interesit, etikës në sektorin publik dhe krijimin e mekanizmave për zbatimin e Ligjit të ri “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”⁵⁹. Nga institucionet e pavarura të mbikëqyrjes, që nga krijimi i tij në vitin 2003, ILDKPKI ka marrë kompetenca të tjera për shkak të ndryshimeve të

56 Raporti Vjetor 2015, http://www.idp.al/images/autoriteti/Raporte_Vjetore/Raporti_Vjetor_2015.pdf.

57 Raporti Vjetor 2015, http://www.idp.al/images/autoriteti/Raporte_Vjetore/Raporti_Vjetor_2015.pdf.

58 Seanca dëgjimore me Komisionerin. <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/11/Procesverbal-dat---15.11.2016.pdf>

59 Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.



vazhdueshme në ligjin për deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit.⁶⁰ Ligji për deklarimin e pasurive përcakton rregullat për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të tyre, detyrimet financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe personat e lidhur me to.⁶¹ Ndërsa ligji për konfliktin e interesit përcakton rregullat, mjetet, metodat, procedurat, përgjegjësitë dhe kompetencat për identifikimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesit.⁶² Një hyrje e re këtë vit është Ligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” për monitorimin e zbatimit të së cilës përgjegjës është ILDKPKI.

Amendamentet që iu bënë ligjit për deklarimin e pasurive dhe konfliktit të interesit në vitin 2014 lidhen me rritjen e numrit dhe shpeshtësisë së kontrolleve nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, duke e bërë të detyrueshme shpalljen e parave cash mbi një vlerë të caktuar dhe kërkesën për depozitimin në banka të shumave të tilla. Paraqitja e informacionit të rremë është bërë tashmë vepër penale, ndërkohë që pritet të nisë puna për zbatimin e ligji i ri për mbrojtjen e sinjalizuesve për rastet e korrupsionit dhe ngritjen e strukturave përkatëse për zbatimin e tij.⁶³

Kompetencat e ILDKPKI përfshijnë kontrollin e drejtpërdrejtë të deklarimeve të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim; mbledhjen e të dhënave, kryerjen e hetimeve dhe investigimeve administrative rreth deklarimeve të personave që kanë detyrimin për deklarim, sipas këtij ligji; bashkëpunimin me organet e kontrollit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.⁶⁴

ILDKPKI ka buxhetin e vet të pavarur dhe Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI zgjidhet me shumicë të cilësuar të anëtarëve të Kuvendit. Ai raporton çdo vit në Kuvend për veprimtarinë e kryer në vitin pararendës si dhe sa herë që thirret nga Kuvendi.

Punonjësit e institucionit të policisë janë subjekt i ligjeve për zbatimin e të cilave është përgjegjës institucioni i ILDKPKI-së. Prandaj, ligji për deklarimin e pasurive përcak-

60 Ligji Nr. 45/2014 datë 24.4.2014 “Për Deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar; Ligji Nr. 44/2014 datë 24.4.2014, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

61 Neni 1, Ligji Nr. 45/2014 datë 24.4.2014 “Për Deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.

62 Ligji Nr. 44/2014 datë 24.4.2014, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

63 Strategjia Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/08/Albania_Inter-sectoral_Strategy_against_Corruption_2015-2020_Eng.pdf.

64 Neni 17 Ligji Nr. 45/2014 datë 24.4.2014 “Për Deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.



ton se drejtorët e përgjithshëm, drejtorët e drejtorive dhe shefat e sektorëve, (komisariateve) në qendër, rrethe e qarqe janë subjekte të këtij ligji.⁶⁵ Kuadri i përgjithshëm ligjor për konfliktin e interesit dhe deklarimin e pasurive përcakton se vetëm niveli i zyrtarëve të lartë dhe të mesëm të menaxhimit në Policinë e Shtetit janë subjekt i këtyre ligjeve, të cilat nuk mbulojnë të gjithë organizatën e policisë. Raporti i hartuar nga ILDKPKI për vitin 2015 nuk i referohet rasteve të auditimit ku përfshihen zyrtarë të Policisë së Shtetit dhe as ndonjë raporti tjetër të veçantë në këtë drejtim. Kështu, vetëm një numër i kufizuar zyrtarësh të policisë bëjnë pjesë në kategorinë e subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji.⁶⁶ Sipas kuadrit ligjor në fuqi, zyrtarë të nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues sipas legjislacionit të shërbimit civil, zyrtarë të nivelit të lartë e të mesëm të Policisë së Shtetit dhe të Forcave të Armatosura, sipas sistemit të gradave dhe detyrave të zbatueshme për këto institucione publike, zyrtarët e nivelit të lartë dhe të mesëm, të barasvlershëm me zyrtarët në pozicionet drejtor drejtorie, drejtor drejtorie të përgjithshme dhe titullarë të enteve rregullatorë apo institucioneve të tjera të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil, si dhe prefekti: a) nuk mund të jenë drejtues në organizatat fitimprurëse; b) nuk mund të jenë anëtarë në organet drejtuese të një shoqërie tregtare ose në një organizatë jofitimprurëse; c) nuk mund të ushtrojnë veprimtari private, që krijon të ardhura; ç) mund të zotërojnë në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, pa asnjë kufizim, me përjashtim të rastit kur shoqëria ushtron veprimtari në një sferë që përputhet ose pritet me sferën e juridiksionit të zyrtarit dhe të kompetencës së tij për të vepruar.⁶⁷

Sipas këtij konfigurimi të përgjithshëm, konflikti i interesit rregullohet në mënyrë më specifike nëpërmjet një sërë rregulloresh të brendshme që përcaktojnë normat dhe parimet e etikës dhe të disiplinës për Policinë e Shtetit ku përfshihet i gjithë personeli i kësaj organizate. Për më tepër, Ligji “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” ka fuqinë për të verifikuar asetet, pronat, interesat, punësimin shtesë, dhuratat dhe privilegjet e zyrtarëve të veçantë në bazë të ankesave dhe raportimeve.⁶⁸

Megjithatë, raporti i Transparency International për vitin 2016 thekson se kuadri ligjor për konfliktin e interesit dhe dhuratat e mikpritjen është i pamjaftueshëm. Rregullimi i

65 Neni 3, Ligji Nr. 45/2014 datë 24.4.2014 “Për Deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar. <http://www.hidaa.gov.al/ligji-nr/>.

66 A. Dyrmishi & E. Hroni, (2014). Conflict of Interest in the Albanian Police. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/conflict_of_interest_-_cesa_-_english1.pdf.

67 Neni 31, Ligji Nr. 44/2014 datë 24.4.2014, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.

68 Nenet 38 dhe 39, Ligji Nr. 70/2014, datë 10.7.2014, “Për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme”.



lobimit/ndërhyrjes mungon plotësisht dhe kufizimet e punësimit pas lënies së detyrës/funksionit janë vetëm për Drejtorin e Policisë së Shtetit. ILDKPKI dëshmon se zbatimi i ligjit për konfliktin e interesit është pika e saj e dobët. ILDKPKI nuk iu përgjigj në mënyrë të qartë pyetjeve në lidhje me auditimin e plotë të deklaratave të pasurisë të zyrtarëve të lartë të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave dhe nuk ka dëshmi të tjera që të vërtetojnë nëse ata janë audituar plotësisht ndonjëherë.⁶⁹

Kapacitetet administrative, teknike dhe financiare të ILDKPKI kanë nevojë të forcohen më tej në mënyrë ky institucion të mund të përballojë me sukses kontrollin e deklarimit të pasurisë dhe të marrë përsipër kompetenca të reja të dhëna nga Ligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Megjithatë, lidhur me deklarimin e pasurive dhe parandalimin e konfliktit të interesit në Policinë e Shtetit, ILDKPKI duhet të bëjë trajnime të vazhdueshme për rregullat dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. Nga ana tjetër, ILDKPKI duhet të kontribuojë në forcimin dhe promovimin e përgjegjshmërisë dhe mbikëqyrjes së Policisë së Shtetit me anë të hetimeve dhe inspektimeve të rregullta.

Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK)

Shqipëria akoma nuk ka një agjenci të specializuar antikorruption të pavarur nga ekzekutivi, që i raporton vetëm Kuvendit. Gjithsesi, që nga viti 2013, qeveria i ka ngarkuar Ministrin të Shtetit për Çështjet Vendore detyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK). Pranë Kryeministrit funksionon edhe Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorruption (NKBA),⁷⁰ e cila ka kompetenca për të kryer hetime administrative dhe propozuar masa disiplinore dhe administrative në ministrinë dhe institucionet në varësi të Kryeministrit. Por roli i NKBA-së është ende i paqartë dhe nuk përfshin parandalimin e korrupsionit.⁷¹ Raportet e korrupsionit i dorëzohen Njësies për Kontroll të Brendshëm dhe Anti-korrupsion në Kryeministri, për të cilat nuk ka informacion publik. Ankesat për korrupsion mund të plotësohet në portalin në internet, të krijuar nga qeveria në vitin 2015. Statistikat e korrupsionit mblidhen nga një grup ndërinstitucional pune ku përfshihen Ministria e Drejtësisë, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Gjykata e Lartë, dhe ILDKPKI. Nuk ka sistem të vlerësimit

69 Transparency International. Albania National Integrity System Assessment 2016. http://files.transparency.org/content/download/2031/13136/file/2016_NISAlbania_SQ.pdf.

70 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 94 Date 15.02.2006 “ Për miratimin e rregullores për funksionet dhe procedurat e kontrollit të brendshëm administrativ dhe antikorruption të Këshillit të Ministrave”.

71 A. Dyrmishi (2016). “Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri 2.0” (2016), Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>, f. 35.



të rrezikut sektorial të ndërmarrë si në nivel politikash ashtu edhe në nivel të zbatimit të ligjit.⁷²

Që nga viti 2015, në portalin në internet janë depozituar 1530 ankesa ndaj policisë⁷³. Policia renditet mes institucioneve me numrin më të lartë të ankesave. Trendi i ankesave të policisë ka rënë në vitin 2016, për shkak të kanaleve të shumta të ankesave në vend. Për më tepër, sa i përket mbikëqyrjes policore, aktiviteti i KKK konsistonte kryesisht në hartimin e një strategjie ndërsektoriale për luftën kundër korrupsionit 2015-2020 dhe monitorimin e zbatimit të planit të saj të veprimit 2015-2017. Plani i Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) përcakton një sërë detyrash, për zbatimin e të cilave është përgjegjëse Policia e Shtetit. Këto detyra janë zbatuar pjesërisht (siç paraqitet në Tabela 2).⁷⁴

Tabela 2: Zbatimi i masave të parashikuara në Planin e Veprimit të SNKK për të cilat PSH është përgjegjëse

Produkti	Zbatuar
Kryerja e testimit të integritetit në Polici	Pjesërisht
Ndërtimi i sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes në të gjitha Komisarariatet e Policisë	Pjesërisht
Pajisja e punonjësve të policisë rrugore dhe patrullës së përgjithshme me kamera vëzhgimi gjatë kryerjes së detyrave	Pjesërisht
Rritja e numrit të operacioneve me përdorimin e teknikave speciale të hetimit me 5% çdo vit; Rritja e numrit të hetimeve proaktive për korrupsion me 5% çdo vit	Pjesërisht

Rekomandime

Parlamenti

- ▶ Duhet të miratohet legjislacioni në mënyrë që të sigurohen procedurat standarde të mbikëqyrjes parlamentare të të gjitha institucioneve të sigurisë.
- ▶ Komisioni për Sigurinë Kombëtare duhet të mbajë takime të rregullta me të gjithë aktorët përgjegjës për mbikëqyrjen e shërbimit policor dhe të punëve të brendshme. Këto takime duhet të pasohen nga miratimi i masave për përmirësimin e funksionimit të policisë, me fokus të veçantë tek integriteti.

72 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf, f.18.

73 Burimi i statistikave: <http://stat.stopkorrupsionit.al/department/10>.

74 Shih: <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>.



- ▶ Komisioni për Sigurinë Kombëtare duhet të kontrollojë zbatimin e masave të mbikëqyrjes së fshehta nga Drejtoria e Policisë së paku dy herë në vit, me fokus të veçantë tek ligjshmëria dhe rezultatet e arritura nga zbatimi i masave të tilla.
- ▶ Deputetët duhet të inkurajohen që të përdorin në mënyrë sa më aktive instrumentet e seancave plenare, interpelancave, dëgjosat publike, si dhe komisionet hetimore apo komisionet e përkohshme.
- ▶ Parlamenti duhet të përmirësojë kapacitetet administrative që mbështesin komisionet parlamentare.

Organet e specializuara të mbikëqyrjes

- ▶ Duhet të rriten burimet njerëzore dhe financiare me qëllim që të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efektive. Të rritet diversifikimi i fondeve përmes thithjes së asistencës ndërkombëtare.
- ▶ Duhet të vendoset bashkëpunimi me Policinë e Shtetit në mënyrë që të ofrohet trajnim i vazhdueshëm për rregulloret dhe zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi. Organet e pavarura të mbikëqyrjes duhet të kontribuojnë në forcimin dhe promovimin e kërkesës së llogarisë dhe mbikëqyrjes së Policisë së Shtetit me anë të hetimeve dhe inspektimeve të rregullta.
- ▶ Duhet të rriten kapacitetet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ana e organeve të mbikëqyrjes për Policinë e Shtetit.
- ▶ Për më tepër, shoqëria civile duhet të zgjerojnë fokusin e saj për monitorimin e veprimtarisë së policisë, në fusha të tilla si forcimi institucional, transparenca e shpenzimeve buxhetore, procedurat e prokurimit, etj.



PËRGJEGJSHMËRIA E BRENDSHME

Kontrolli i Brendshëm

Është hartuar dhe miratuar kuadri institucional anti-korrupsion për të siguruar përgjegjshmërinë e Policisë së Shtetit. Mekanizmat kryesorë të kontrollit të brendshëm në punën e Policisë së Shtetit janë Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SH-ÇBA) që është i pavarur nga Policia e Shtetit dhe i raporton Ministrin të Brendshëm si dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP) brenda strukturës së policisë, e cila i raporton Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. DSP dhe SHÇBA duhet të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre dhe duhet të shkëmbejnë rregullisht informacionet për hetimin e ankesave ndaj punonjësve të policisë.⁷⁵

Siç përcaktohet edhe në Ligjin “Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Punëve të Brendshme”, “Misioni i Shërbimit është garantimi i zbatimit të ligjit, mbrojtja e interesave të ligjshme të shtetit, si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada.” Ky organ është përgjegjës edhe për krijimin e një sistemi efikas të ankesave, që do të nxisë qytetarët të denoncojnë shkeljet e policisë. Subjekti i kontrollit të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave janë të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit. Objekt i veprimtarisë së Shërbimit janë:

1. parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale, si dhe i shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;
2. inspektimi dhe trajtimi i ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërmbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit;
3. ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave;
4. verifikimi i pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime;
5. analiza, studime dhe rekomandime të përgjithësuara në bazë të inspektimeve dhe hetimeve për aspekte të rëndësishme të organizimit e të funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në drejtim të sigurisë publike.⁷⁶

Gjatë vitit 2015,⁷⁷ Ligji Nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe An-

75 Rregullorja e Policisë së Shtetit, Neni 218.

76 Neni 5. Ligji Nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

77 Të dhënat disponohen vetëm për vitin 2015.



kesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” u vu plotësisht në zbatim dhe u vazhdua më tej me konsolidimin e kuadrit ligjor për monitorimin dhe kontrollin e strukturave nëpërmjet hetimit administrativ dhe shkeljeve që përbëjnë vepër penale si dhe me rritjen e integritetit të policisë. Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave ka zërin e vet në buxhetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky shërbim është i organizuar në nivel qendror dhe në nivel qarqesh (12 qarqe) dhe kryen dy funksione: hetimin e veprave penale (Departamenti i Kërkimit dhe Hetimit) dhe inspektimin (Drejtoria e Inspektimit dhe Ankesave).

Për sa i përket pavarësisë politike të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, vihet re se kjo pavarësi është ende e brishtë edhe pse Shërbimi është i pavarur nga Policia e Shtetit si dhe edhe pse anëtarët e këtij shërbimi nënshkruajnë të ashtuquajturën “deklaratë e depolitizimit”. Megjithatë, Shërbimi është nën komandën e drejtpërdrejtë të Ministrit të Punëve të Brendshme, i cili është shefi ekzekutiv i saj me fuqinë për të përcaktuar prioritetet e saj, që miraton strukturën, nxjerr urdhrat dhe udhëzime që rregullojnë veprimtarinë e shërbimit, përfshirë këtu edhe procedurat e inspektimit. Ministri ka fuqi ekskluzive për të emëruar drejtorin e Shërbimit. Misioni i financuar nga Asistenca e BE-së për Policinë në Shqipëri (PAMECA) - ka rekomanduar që Kuvendi të ketë një rol në këto emërimë, në përputhje me standardet ndërkom-bëtare për organet e mbikëqyrjes së policisë.⁷⁸

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat harton raportet vjetore publike që duhet të pasurohen më tej me informacione specifike për veprimtarinë e tij. Raporti vjetor i vitit 2015 është ende në version prezantimi në PowerPoint. Siç përcaktohet në ligj, Veprimtaria e Shërbimit mbikëqyret nga Kuvendi, Kryeministri, dhe Prokurori i Përgjithshëm.⁷⁹

SHÇBA ka të drejtë të bëjë kallëzime penale në prokurori. Aktualisht nuk ka asnjë kallëzim për kontrollin e ushtruar nga institucionet e lartpërmendura. Për më tepër, me qëllim që të luftohet korrupsioni brenda organizatës policore, SHÇBA ka autoritetin të kryejë teste integriteti për punonjësit e policisë⁸⁰. Kjo është një detyrë shumë e rëndësishme në parandalimin e korrupsionit. Megjithatë një gjë e tillë nuk është zbatuar në praktikë. Ky proces mund të marrë kohë të konsiderueshme për t’u konsoliduar për shkak se për të nevojitet një staf i trajnuar dhe i specializuar si dhe duhet të hartohen procedurat standarde.

78 Transparency International. Albania National Integrity System Assessment 2016. http://files.transparency.org/content/download/2031/13136/file/2016_NISAlbania_SQ.pdf, p.115.

79 Neni 23. Ligji Nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

80 Neni 23, Po aty.



Trajtimi i ankesave ndaj policisë

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

Trajtimi i ankesave është një nga përgjegjësitë kryesore të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Në këtë drejtim, format e paraqitjes së ankesave nga publiku janë plotësisht të krijuara dhe funksionale. Megjithatë, kur bie fjala për statistika, SHÇBA nuk është ende struktura kryesore që raporton rastet e shkeljeve disiplinore të punonjësve të policisë.

Për periudhën shtator 2014 - shtator 2016 Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ka trajtuar 1769 ankesa të paraqitura nga publiku përmes kanaleve të ndryshme (si numri i telefonit falas, email, etj.). Pas hetimit administrativ nga SHÇBA, në total 20 policë u kallëzuan për ndjekje penale. Ndërkohë, janë identifikuar shkelje administrative për 115 policë, ku për ta është rekomanduar fillimi i procedurave disiplinore nga ana e Drejtorisë së Standardeve Profesionale.

Për më tepër, nga janari 2016 deri në tetor 2016, SHÇBA ka trajtuar 657 ankesa. Nga shqyrtimi administrativ është arritur në përfundimin se 9 policë janë kallëzuar për ndjekje penale dhe është rekomanduar fillimi i procedurave disiplinore nga ana e Drejtorisë së Standardeve Profesionale për 79 oficerë policie.

Në lidhje me aktivitetin e inspektimit, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat gjatë vitit 2015 ka kryer 11 inspektime të planifikuara dhe 10 inspektime të paplanifikuara dhe 30 inspektime janë kryer në bazë të ankesave. Si rezultat, janë dhënë 153 konkluzione dhe 133 rekomandime. Në vitin 2015, SHÇBA raportoi 119 raste të veprimtarisë korruptive ku përfshihej abuzimi me detyrën me marrje ryshfeti, sjellja joprofesionale në kryerjen e detyrave funksionale, favorizimi ose përfshirja në veprimtari të paligjshme, të tilla si trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, kontrabanda, konkurrenca e pandershme, etj., në mënyrë që të përfitohet ryshfet.⁸¹

Drejtoria e Standardeve Profesionale (DSP)

Në bazë të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e policisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit funksionon Drejtoria për Standarde Profesionale (DSP), e cila ndër të tjera, merret me shkeljet dhe sjelljen jo-etike të punonjësve të policisë, përfshirë këtu edhe rastet e përdorimit të dhunës nga këta të fundit.

81 Raporti Vjetor i Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave 2015, <http://shcba.gov.al/images/RVP2015.pdf>.



Kjo drejtori, përmes Sektorit të Standardeve dhe Performancës, kryen vlerësimin e të gjitha strukturave të Policisë së Shtetit, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor në lidhje me zbatimin e procedurave standarde operative, si dhe vlerësimin e performancës së punonjësve të Policisë së Shtetit.

Vlerësimi i performancës kryhet në bazë të programit vjetor të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për strukturat e policisë dhe për tematika të ndryshme, të cilat përcaktohen në bazë të problemeve të hasura në aktivitetet e përditshme. Gjithsesi, duhet parë nëse këtyre vlerësimeve u jepet rëndësia e duhur dhe nëse ato kanë ndikim në ndryshimin e performancës së policëve apo nëse ky vlerësim është thjesht një formalitet.

Për më tepër, këto struktura hartojnë raportet e vlerësimit, ku përveç problematikave të hasura, jepen edhe rekomandime për të përmirësuar procedurat e punës si dhe për fillimin e procedimit disiplinor për punonjësit që shkelin procedurat standarde të punës. Ky hetim kryhet nga Sektori i Disiplinës pranë kësaj drejtorie.

Drejtorja e Standardeve Profesionale, nëpërmjet Sektorit të Standardeve dhe Performancës dhe Sektorit i Disiplinës, kryen vlerësime dhe heton rastet e shkeljeve dhe sjelljes së gabuar të punonjësve të policisë, raste që raportohet se kanë shkelur rregulloren e Policisë së Shtetit.

Sektori i Disiplinës kryen edhe hetime për sjellje të gabuar dhe për shkeljet e punonjësve të policisë duke rekomanduar edhe marrjen e masave përkatëse për shkeljet e evidentuara.

Rastet e sjelljes së gabuar të punonjësve të policisë dhe ato që lidhen me aktet e korrupsionit trajtohen nga Sektori i Ankesave në Drejtorinë për Standarde Profesionale. Ky sektor kryen verifikimet e çdo ankesë dërguar nga ana e publikut ndaj punonjësit të policisë, nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit si dhe me postë elektronike ose nëpërmjet portalit antikorrupsion, aplikacionit “Komisariati Dixhital”, ose me telefon. Shkeljet e lehta disiplinore trajtohen edhe nga strukturat e policisë në polici dhe në këto raste merren masa të lehta disiplinore.

Kështu, për periudhën 1 janar - 6 shtator 2016 Drejtoria e Standardeve Profesionale⁸² trajtoi gjithsej 457 raste të shkeljeve disiplinore të kryera nga punonjësit e policisë, dhe rekomandoi masat e mëposhtme administrative. Shih tabelën më poshtë.

**Tabela 3: Numri i masave disiplinore të dhëna nga Drejtoria e Standardeve Profesionale 1 janar - 6 shtator 2016**

Masat disiplinore	Përfundim nga Policia	Pushuar nga puna	Ulje në gradë deri në 6 muaj	Shtyrje e gradimit me deri në dy vjet	Mbajtje page deri në 5 ditë pune
Numri i rasteve	46	2	5	114	2

Ndërkohë për të njëjtën periudhë raportuese, në total u hetuan 41 raste të dyshuara për veprime korruptive dhe u rekomanduan masat disiplinore në vijim, siç paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Masat disiplinore	Përfundim nga Policia	Shtyrje e gradimit me deri në dy vjet	Rekomandim për masa të lehta
Numri i rasteve	21	15	5

Po ashtu, u hetuan 29 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut (dhunë, shoqërim i paligjshëm, diskriminim) nga oficerë policie dhe u rekomanduan masat e mëposhtme disiplinore:

- ▶ “Përfundim nga Policia”: 3 raste;
- ▶ “Ulje në gradë deri në 6 muaj”: 1 rast;
- ▶ “Shtyrje e gradimit me deri në dy vjet” : 1 rast;
- ▶ “Rekomandim për masa të lehta” : 24 raste.

Tabela 4: Masat disiplinore të rekomanduara sipas strukturës, Periudha: 1 janar - 6 shtator 2016

Struktura	Përfundim nga Policia	Pushim nga puna	Ulje në gradë deri në 6 muaj	Shtyrje e gradimit me deri në dy vjet	Mbajtje page deri në 5 ditë pune	Gjithsej (punonjës)
Drejtoria e Policisë e Qarkut (DPQ) Tiranë	13			21	2	36
DPQ Durrës	1			4		5
DPQ Elbasan	1			1		2
DPQ Korçë	2	1				3
DPQ Gjirokastrë				1		1



DPQ Vlorë	6			4		10
DPQ Fier	3	1				4
DPQ Berat			1	1		2
DPQ Shkodër	6		2	13		21
DPQ Kukës	2			1		3
DPQ Dibër				11		11
DPQ Lezhë	2			18		20
Drejtoria e Qarkut për Kufirin dhe Migracionin (DQKM) Tiranë				5		5
DQKM Durrës				-	-	-
DQKM Korçë	1					1
DQKM Gjirokastrë	1			3		4
DQKM Vlorë	1			21		22
DQKM Shkodër				4		4
DQKM Kukës	4			3		7
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPP SH)			2	2		4
Strukturat e pavarura	3			1		4
Gjithsej	46	2	5	114	2	169

Shkeljet disiplinore në shumicën e rasteve janë identifikuar dhe raportuar nga strukturat vendore (Drejtoritë e Policisë në Qarqe dhe Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit), Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, Inspektimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, strukturat e auditit, Drejtoria e Standardeve dhe Performancës si dhe strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, etj.



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur raste të shkeljeve disiplinore sipas strukturave të raportimit:

Struktura	Numri i punonjësve
DPQ	176
DQKM	49
SHÇBA	91
Inspektim nga Ministria	1
Audit	5
DSP	80
DPPSH	39
Avokati i Popullit	2
Strukturat e pavarura	5
Prokurori/Gjykatë	9

Në lidhje me analizën e masave të rekomanduara disiplinore sipas gradave, ka një tendencë të qartë që tregon numër më të madh të shkeljeve nga nivelet e ulëta të punonjësve të policisë, krahasuar me ato në nivelet drejtuese.

Tabela 5: Masat disiplinore sipas gradës

Masat disiplinore/ grada	Përfundim nga Policia	Pushim nga puna	Ulje në gradë deri në 6 muaj	Shtyrje e gradimit me deri në dy vjet	Mbajtje page deri në 5 ditë pune	Rekoman- dim për masa të lehta	Gjithsej (punonjës)
Drejtues i parë	-	-	-	-	-	-	-
Drejtues	-	-	1	3	-	-	4
Kryekomisar	-	-	1	2	-	2	5
Komisar	3	-	1	8	-	23	35
Nënkomisar	10	-	2	27	-	44	83
Inspektor	33	-	-	74	-	113	220
Personel civil	-	2	-	-	2	5	9
Total	46	2	5	114	2	187	356



Rekomandime

- ▶ Përmirësimi i koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit mes mekanizmave të kontrollit të brendshëm; për rritjen e efikasitetit rekomandohet organizimi i takimeve të rregullta të fokusuara në problemet e identifikuara në punën e policisë dhe propozimi i masave të përbashkëta për zgjidhjen e tyre.
- ▶ Plotësimi i Ligjit për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të parashikojë detyrimin e Shërbimit për të paraqitur një raport vjetor për punën e tij në Kuvend.
- ▶ Sigurimi i shkëmbimit të informacionit ndërmjet Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Lirinë e Informimit, Avokatit të Popullit.
- ▶ Publikimi i rregullt i informacioneve të përmbledhura për ankesat e qytetarëve ndaj policëve në faqen e internetit të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, si dhe rezultatet e tyre.



MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Në pjesën në vijim jepet një pasqyrë e planifikimit të burimeve njerëzore, rekrutimit dhe përzgjedhjes, edukimit dhe trajnimit policor, etikës policore dhe disiplinës, si dhe vlerësimi e performancës dhe ngritja në detyrë. Gjithashtu, në këtë pjesë shqyrtohen pengesat që ekzistojnë në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore brenda Policisë së Shtetit dhe sfidat në zbatimin e dispozitave ligjore.

Planifikimi i burimeve njerëzore

Ligji dhe rregullorja e Policisë së Shtetit kanë shtruar rrugën për reformën dhe standardizimin e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e policisë. Legjislacioni aktual në fuqi rregullon planifikimin e burimeve njerëzore; rekrutimin dhe përzgjedhjen; edukimin dhe trajnimin, ngritjen në detyrë; menaxhimin e performancës; shpërblimin dhe ndëshkimin; si dhe etikën dhe disiplinën policore. Punonjësit e policisë (personeli me uniformë) janë subjekt i ligjit “Për nëpunësin civil”.

Ndër prioritetet e qeverisë në lidhje me Policinë e Shtetit janë profesionalizimi i mëtejshëm i policisë, rritja e numrit të punonjësve të policisë, përmirësimi i kushteve të punës, rritja e pagave dhe ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme si dhe mbështetja për Akademinë e Sigurisë.⁸³

Numri i punonjësve të policisë që mbulojnë vendin pretendohet të jetë i pamjaftueshëm, në krahasim me mesataren e vendeve të Ballkanit. Aktualisht, numri i policëve është rritur në 9,894 policë, 232.8 për 100,000 banorë. Megjithatë, rritja e numrit të punonjësve të policisë duhet të përkojë me trajnimin e duhur policor dhe të jetë pjesë e një strategjie afatgjatë për racionalizimin e burimeve njerëzore brenda Policisë së Shtetit. Në këtë aspekt ka shumë rëndësi qasja strategjike për të parandaluar problemet e shkarkimeve/pushimeve në të ardhmen si dhe që të mos përdoret rekrutimi në polici si shpërblim për mbështetjen politike.

Për më tepër, si rezultat i dispozitave ligjore për Policinë e Shtetit të prezantuara kohët e fundit ka pasur ndryshime në strukturën organizative të policisë që sipas Raportit të KE-së për vitin 2016 konsiderohet se ka përmirësuar kapacitetin e përgjithshëm të kësaj organizate. Nga ana tjetër, janë forcuar njësitë e specializuara të krimit ekonomik dhe financiar, pastrimit të parave dhe hetimit të aseteve kriminale, si dhe të Drejtorisë Qendrore të Inteligjencës dhe Analizës së Krimit. Megjithatë, ende ka mungesë me staf

83 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 185, datë 25.02.2015, “për Organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.



të specializuar për çështjet financiare dhe fiskale. Është përmirësuar niveli i përgjithshëm i pajisjeve dhe logjistikës, edhe pse i pamjaftueshëm, veçanërisht në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit⁸⁴. Nga ana tjetër, raporti vë në dukje se normat e larta të largimit të stafit vazhdojnë të dobësojnë kapacitetet institucionale dhe operacionale të Policisë së Shtetit. Kjo është karakteristikë e ndryshimit të qeverive gjë që ndikon edhe në Policinë e Shtetit. Në këtë drejtim, në vitin 2014, me kërkesë të deputetëve të opozitës u ngrit një komision hetimor për të shqyrtuar largimet nga puna në Policinë e Shtetit, pas formimit të qeverisë së re në vitin 2013. Komisioni hetimor ka përfunduar aktivitetin e tij pa gjetjet të konsiderueshme për pretendimet në lidhje me shkarkimet e paligjshme në Policinë e Shtetit.

Rekrutimet

Kohët e fundit është publikuar me të madhe procesi i rekrutimit, duke qenë se krijimi i një brezi të ri policësh të rinj të trajnuar mirë ishte një nga angazhimet politike të qeverisë. Prosesi i rekrutimit në Policinë e Shtetit bazohet ende në konkurrimin publik. Janë hartuar dhe zbatuar procedura të qarta të aplikimit të cilat i janë vënë në dispozicion publikut. Sipas Ligjit për Policinë e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planifikimit të rekrutimit, arsimimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë⁸⁵. Kuotat e pranimit në Policinë e Shtetit caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit bazuar në vlerësimin e nevojave të Drejtorive të Policisë në qarqe, propozimet e komisariateve dhe rajoneve të policisë. Në fazën e pranimit, parashikohen kuota edhe për gjininë më pak të përfaqësuar dhe për minoritetet⁸⁶. Po ashtu, rregullorja e policisë përcakton procesin e apelit pas konkursit.

Në fillim të këtij viti për Shkollën Bazë të Policisë u përzgjedhën 300 kadetë të rinj nga 5020 aplikantë. Pavarësisht nga fakti se konkursi i pranimit u publikua në media, nuk ka të dhëna në dispozicion për ankesat e rezultateve të kësaj gare. Nga ana tjetër, nuk bëhen të ditura të dhënat për nivelin e braktisjes së shkollës.

Gjithsesi, prioriteti kryesor për vitin 2015 ishte reformimi i sistemit të arsimit të policisë. Ky vit shënoi brezin e parë të Akademisë së Sigurisë. Përveç Shkollës Bazë të Policisë, Akademia e Sigurisë, pas një mungese prej disa vitesh, do të ofrojë diploma Bachelor dhe Programe Master Profesional si dhe kërkime nëpërmjet fakulteteve të tij. Njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë përbëhen nga: a) Fakulteti për Sigurinë

84 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf f. 20.

85 Neni 20, ii), Ligji Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".

86 Neni 128, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 09.16.2015 "Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit".



Publike; b) Fakulteti për Hetimin e Krimit; c) Njësia e Kërkimit Shkencor. Struktura e Akademisë miratohet nga Ministri i Brendshëm, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.⁸⁷

Vlerësimi i Performancës dhe Ngritja në Detyrë

Dispozitat ligjore parashikojnë vlerësimin e punës⁸⁸ dhe ngritjen në detyrë⁸⁹. Vlerësimi i performancës së strukturave të policisë kryhet nga Sektori për Standardet dhe Performancën pranë Drejtorisë së Standardeve Profesionale. Kjo është një procedurë relativisht e re. Prandaj, nuk ka të dhëna të mjaftueshme në dispozicion të publikut për performancën aktuale të punonjësve të policisë. Me sa duket praktika aktuale e vlerësimit të performancës është më shumë një procedure formale dhe thjesht sa për të shënuar “u krye”. Nga ana tjetër, ngritja në detyrë në përgjithësi bëhet në përputhje me dispozitat ligjore, por janë po aq të rëndësishme edhe rrjetet dhe lidhjet informale.⁹⁰

Rekrutimi i grave është përmirësuar për shkak të përcaktimit të sistemit të kuotave me 50% në fazën e pranimit, detyrim i vendosur në vitin 2011. Në Shqipëri ka pasur një rritje të lehtë të grave që mbajnë role drejtuese në polici, nga 6.6 për qind në vitin 2012 në 9.9 për qind sot. Në përgjithësi, 1,468 gra tani përfaqësojnë 14 për qind të Policisë së Shtetit, nga 9 për qind që kishte në vitin 2011.⁹¹ Në dhjetor të vitit 2015 për herë të parë një grua u emërua shefe komisariatit (në Komisarlatin e Librazhdit), si rezultat i një programi trajnimi udhëheqjeje mbështetur nga Programi Ndërkombëtar i Asistencës dhe Trajnimit për Hetimin e Krimeve (International Criminal Investigative Training Assistance Program - ICITAP) dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara UN Women. Ky trajnim u përsërit në vitin 2016 me pjesëmarrjen e 29 oficerëve të nivelit të lartë të policisë.

Trajnimi i vazhdueshëm

Rregullorja e Policisë përcakton trajnimet e vazhdueshme profesionale të punonjësve të policisë⁹². Trajnimi i vazhdueshëm profesional planifikohet gjatë gjithë vitit kalendarik. Kjo përfshin një qasje strategjike bazuar në vlerësimin e nevojave të strukturave

87 Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

88 Neni 96, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 09.16.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.

89 Kreu VII i Ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe Neni 125, Ecuria në karrierë, Rregullorja e Policisë së Shtetit.

90 Intervistë me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

91 Shih: <http://www.unwomen.org/en/news/stories/2016/7/steering-the-path-to-leadership-for-women-police-officers-in-albania#sthash.qdTAvG1k.dpuf>.

92 Neni 156, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 09.16.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.



të policisë në të gjithë vendin. Strategjitë publike që mund të gjenden për këtë aspekt janë të vjetruara.

Po ashtu, Buletini mujor i Ministrisë së Punëve të Brendshme jep informacione për shpeshësinë dhe tematikën e trajnimeve të organizuara. Bazuar në të dhënat që na janë vënë në dispozicion, trajnimet për integritetin duket se nuk organizohen shpesh. Akademia e Sigurisë organizon kurse trajnimi për specializimin e mëtejshëm të punonjësve të policisë në detyrë, në përputhje me nevojat e shërbimit modern profesional të policisë. Të gjithë rekrutët e rinj të policisë do të duhet të kenë përfunduar Shkollën Bazë të Policisë. I ashtuquajtimi trajnim 6-mujor tashmë do të zgjatet deri në një vit dhe më pas ata që do të zgjidhen do të vazhdojnë studimet e mëtejshme në Akademinë e Sigurisë. Shkolla Bazë e Policisë përgatit rekrutë për oficer të përgjithshëm patrulle pas përfundimit me sukses të shkollës.

Edukimi dhe trajnimi policor ka shumë rëndësi për ecurinë në “shkallën” e karrierës në Policinë e Shtetit dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me ngritjen në detyrë.

Buletini mujor i Ministrisë së Punëve të Brendshme, si një nga instrumentet kryesore për informimin e publikut për veprimtarinë e strukturave të MPB-së, përfshirë këtu edhe Policinë e Shtetit, është i përditësuar me të dhëna specifike për trajnimet vetëm për periudhën nga prilli 2016 deri në shtator 2016.⁹³

Tabela 6: Trajnimet e kryera nga muaji prill 2016 to shtator 2016 sipas drejtorisë së përgjithshme dhe strukturave të tjera

Drejtoria/ Struktura	Drejtoria e Përgjithshme për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda	Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin	Drejtoria e Përgjithshme e Rendit Publik	Drejtoria e Përgjithshme për Shërbimet Mbështetëse	Strukturat e tjera të policisë (Trajnimi i policisë)
Numri i pjesëmarrësve	355	151	654	142	944
Numri i trajnimeve	26	16	35	11	48

93 Buletinet mujore të strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme: <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/programi/buletini-i-mpb-se>.



Lloji i trajnimeve	- Lufta kundër lëndëve narkotike; - Krimi kibernetik; -falsifikimi; Analiza e krime, Kërkimet dhe skena e krimit. Trajnimi bazë për teknikat e vëzhgimit.	- legjislatiioni dhe çështjet që lidhen me sigurinë; detare - Përdorimi i pajisjeve të kontrollit; Kursi i instruktorëve të qenit. Identifikimin dhe menaxhimi i rrezikut.	-Kodi Rrugor, - Mbledhja e provave në veprimtari të paligjshme, kumari, -Mbështetje në rastin e përmytjeve dhe programi i zhytjes. Hetimi i krimeve të minoreneve	Për Kodin e Procedurës dministrative	-Trajnimi i integritetit. -Përdorimi i MEMEX; informacioni i klasifikuar, rëndësia e hartimit të një plani strategjik. - Mbrojtja e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në Shqipëri; - Institucionet e ruajtjes dhe mbrojtjes së VIP, -Integrimi i oficerëve femra të policisë në role drejtuese operative.
--------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Rekomandime

- ▶ Përmirësimi i kapaciteteve të trajnimit në Akademinë e Sigurisë duhet të shoqërohet me një përdorim më efikas të këtyre kapaciteteve për të rritur rolin e edukimit dhe trajnimit si instrumente për forcimin e integritetit të policisë.
- ▶ Policia e Shtetit duhet të përditësojë dhe të publikojë Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Policisë. Racionalizimi i njërive organizative dhe pozicioneve drejtuese do të kontribuojë në efikasitetin dhe përgjegjshmërinë e policisë.
- ▶ Përcaktimi i detyrimit të policisë për të miratuar një plan afatmesëm të stafit, të harmonizuar me dokumentet strategjike për zhvillimin e policisë.
- ▶ Policia e Shtetit duhet të punojë që vlerësimi i performancës të jetë më shumë se një procedurë e thjeshtë formale, me prezantimin e mekanizmave të tjerë të kontrollit.



- ▶ Organizimi i trajnimeve të rregullta për etikën policore dhe çështjet e integritetit që lidhen me të.



MENAXHIMI FINANCIAR

Vizioni i përgjithshëm i qeverisë shqiptare⁹⁴ është garantimi i një sistemi financash publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuar dhe zhvillimin ekonomik. Megjithatë, nga sondazhi i Buxhetit të Hapur 2015 për treguesin e transparencës Shqipëria renditet e 38⁹⁵ nga 100 vende. Ky sondazh tregon se qeveria shqiptare i ofron publikut fare pak informacione për buxhetin e saj. Për më tepër, sondazhi tregoi se qeveria shqiptare ka shumë mangësi në ofrimin e mundësive për angazhimin e publikut në procesin e buxhetimit.

Në këtë seksion do të jepet një panoramë e përgjithshme e menaxhimit financiar, kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit si dhe e problemeve me procedurat e prokurimit publik.

Planifikimi i Buxhetit

Siç parashikohet edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, krijimi i një sistemi të shëndetshëm të menaxhimit të financave publike çon në një administratë publike më efikase. Për këtë qëllim, shpenzimet publike duhet të strukturohen në mënyrë që të rrisin në maksimum ndikimin pozitiv në ekonominë kombëtare. Kështu Programi Buxheti Vjetor dhe Afatmesëm (PBA) janë prezantuar si instrumente për përafrimin e buxhetit me politikat e përgjithshme dhe ato sektoriale. PBA ndihmon të sigurojë qëndrueshmërinë e financave publike duke prezantuar një perspektivë afatmesme për ushtrimin e planifikimit të shpenzimeve publike. Për më tepër Sistemi i Planifikimit të Integruar (SPI)⁹⁶ mundëson që strategjitë sektoriale të japin orientime për buxhetin vjetor si dhe për planet e buxhetit afatmesëm. Gjithsesi, kjo qasje nuk është ndjekur në praktikë, duke qenë se dokumentet e strategjive i vlerësojnë fare pak burimet financiare dhe njerëzore që mund dhe duhet të jenë në dispozicion për zbatimin e tyre. Kjo është më se e zakonshme edhe në rastin e policisë dhe fushën e sigurisë publike, ku nuk llogariten kostot për zbatimin e dokumenteve strategjike.

Procesi i buxhetimit në Shqipëri bazohet në programe. Kështu, Ministria e Brendshme administron dhe menaxhon shtatë programet buxhetore nën suazën e Buxhetit të Shtetit, në mënyrë të veçantë: Programi “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”; Programi “Policia e Shtetit”; Programi “Garda Kombëtare”; Programi “Funksionet

94 Strategjia Për Menaxhimin e Financave Publike 2014 -2020.

95 Renditja e Shqipërisë është paksa më e ulët se mesatarja globale prej 45 pikësh.

96 Sistemi i Planifikimit të Integruar është prezantuar në Shqipëri që në vitin 2005.



e deleguara të prefekturës dhe njësive të qeverisjes vendore”; Programi “Shërbimet e Regjistrimit Civil”; Programi “Menaxhimi i Rezervave të Shtetit”; Programi “Emergjencat Civile”.

Programi i Policisë së Shtetit përmban disa nënprograme, si hetimit të krimit, siguria publike, sigurimi i kufijve dhe emigracioni, si dhe trajnimi i policisë. Për secilën nga këto fusha, Ministria e Punëve të Brendshme përcakton qëllime specifike dhe planet përkatëse të veprimit për zbatimin e tyre.

Gjatë punës për hetimin e krimeve, programi ka për qëllim të ofrojë një shërbim hetimor që synon parandalimin, hetimin, dokumentimin dhe luftimin e veprimit të kriminale nëpërmjet zbatimit të masave, metodave, teknikave të posaçme të hetimit dhe zbatimit të ligjeve, me qëllim rritjen e sigurisë, forcimit të paqes dhe sigurimin e një jete më të mirë për qytetarët.

Për sa i përket sigurisë publike, programi synon të sigurojë rend dhe qetësi publike nëpërmjet shërbimeve cilësore profesionale si dhe të garantojë një mjedis të sigurt për komunitetin nëpërmjet policimit me standardet më të larta të performancës.

Ndërkohë, programi për sigurimin e kufirit dhe migracionin ka për qëllim të hartojë dhe zbatojë politika për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror në bashkëpunim me institucionet shqiptare dhe homologë të tjerë të huaj.

Nga ana tjetër, programi i trajnimit të policisë ka për qëllim të ofrojë trajnime të gjithanshme për të gjithë punonjësit e policisë në përputhje me nevojat profesionale të institucionit të policisë.

Gjithsesi, ka mungesë transparence në lidhje me ekzekutimin e buxhetit. Raportet e rregullta nuk janë bërë ende praktikë e Policisë së Shtetit. Për më tepër, raportet e auditimit të brendshëm nuk publikohen në faqen e internetit të Policisë së Shtetit.

Ekzekutimi i Buxhetit

Ekzekutimi i buxhetit është një aspekt shumë i rëndësishëm i menaxhimit efikas financiar dhe në këtë aspekt ky raport do të japë disa të dhëna për tremujorin e parë të vitit 2016.

Gjatë monitorimit të ekzekutimit të buxhetit për tremujorin e parë të vitit 2016, Ministria e Punëve të Brendshme ka realizuar treguesit e mëposhtëm:



	Emërtimi	Plani 2016	Fakti 2016-Q1	% e realizimit
1.	Shpenzimet korrente	18.011.453	3.607.305	20
1.1	Personeli	14.201.950	3.293.077	23.2
1.2	Operative	3.809.503	314.228	8.2
2.	Shpenzimet kapitale	2.012.224	121.058	6
2.1	Financimi i brendshëm	1.712.224	74.137	4.3
2.2	Financimi i huaj	300.000	46.921	15.6
3.	Gjithsej	20.023.677	3.728.363	18.6
	Shpenzimet e të ardhurave jashtë limitit	-	4.717	-
4.	Gjithsej	20.023.677	3.733.080	18.6

In 000 ALL (Burimi: Ministria e Financave (2016))

Siç tregohet në tabelën e mësipërme, realizimi i buxhetit për tremujorin e parë të vitit 2016, krahasuar me planin vjetor të buxhetit të miratuar është 18.6 për qind. Realizimi i shpenzimeve aktuale renditet në rreth 20%, ndërkohë që realizimi i shpenzimeve kapitale është 6% e planit vjetor, gjë që tregon një nivel shumë të ulët të ekzekutimit të buxhetit. Argumentet kryesore të paraqitura nga Ministria e Punëve të Brendshme për nivelin kaq të ulët të realizimit janë: Fondet janë planifikuar për gjysmën tjetër të vitit, shtyrja në zbatim e procesit të prokurimit, apo vonesat në dorëzimin e dokumentacionit teknik dhe financiar për lëvrimin e fondeve.

Shpërndarja e fondeve buxhetore sipas programeve dhe realizimi i shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale për çdo program buxhetor, pa përfshirë shpenzimet e të ardhurave jashtë limitit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

EMRI I PROGRAMIT	SHPENZIMET KORRENTE			SHPENZIMET KAPITALE			Gjithsej realizimi në %
	PLANI	FAKTI	REALIZIMI	PLANI	FAKTI	REALIZIMI	
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	1.060.428	171.397	16.2	257.000	1.843	0.7	13.1
Policia e Shtetit	13.835.268	2.904.069	21	985.000	103.789	10.5	20.3
Garda Kombëtare	1.291.944	281.548	21.8	50.000	0	0	21
Funksionet e deleguara të prefekturës dhe njësive të qeverisjes vendore	537.294	104.755	19.5	0	15.426	0	22.4



Shërbimet e Regjistrimit Civil	1.007.277	125.386	12.4	710.224	0	0	7.3
Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	104.238	20.150	19.3	10.000	0	0	17.6
Emergjencat Civile	175.004	0	0	0	0	0	0
TOTALI	18.011.453	3.607.305	20	2.012.224	121.058	6	18.6
In 000 ALL (Burimi: Ministria e Financave (2016))							

Sa i përket shpenzimet kapitale është e qartë se nuk ka progres në tremujorin e parë të vitit për programet e mëposhtme: “Funksionet e deleguara të prefekturës dhe njësisve të qeverisjes vendore”, “Policia e Shtetit” dhe “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi”, ndërsa për katër programet e tjera buxheti nuk është realizuar. Këto vonesa në realizimin e shpenzimeve kapitale ndikojnë negativisht në performancën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe në punë e Policisë së Shtetit.

Struktura e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar dhe realizimit faktik për tre muajt e parë të vitit 2016 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

KODI	Emri i programit	Struktura e shpenzimeve	
		Buxheti fillestar	Realizimi faktik
01110	Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	6.6	4.6
03140	Policia e Shtetit	74	80.7
03150	Garda Kombëtare	6.7	7.6
01160	Funksionet e deleguara të prefekturës dhe njësisve të qeverisjes vendore	2.7	3.2
01170	Shërbimet e Regjistrimit Civil	8.6	3.4
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit	0.6	0.5
10910	Emergjencat Civile	0.9	0
	GJITHSEJ	100.0	100.0
Burimi: Ministria e Financave (2016)			

“Policia e Shtetit” përfaqëson programin më të madh të buxhetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe fondet e destinuar për këtë program arrijnë në 74% të buxhetit të miratuar për institucionin në vitin 2016.



Sikurse përmendur me lart, programi “Policia e Shtetit” ka disa nënprograme si hetimi i krimit, siguria publike, siguria e kufijve dhe emigracioni si dhe trajnimi i policisë. Për secilën nga këto fusha, Ministria e Brendshme përcakton qëllimet specifike dhe planet e veprimit për zbatimin e tyre.

Me qëllim realizimin e objektivave të Policisë së Shtetit, 14.8 miliard lekë janë alokuar për një periudhë një vjecare. Ndërkoh në tremujorin e parë të këtij viti realizimi i buxhetit paraqitet si vijon:

03140	Policia e Shtetit	Plani	Fakti	Realizimi në %
1.	Shpenzimet korrente	13.835.268	2.904.069	21
1.1	Personeli	11.452.900	2.705.221	23.6
1.2	Operative	2.382.368	198.848	8.3
2.	Shpenzimet kapitale	985.000	103.789	10.5
2.1	Financimi i brendshëm	685.000	72.294	10.55
2.2	Financimi i huaj	300.000	31.496	10.49
3.	SHUMA	14.820.268	3.007.858	20.3
	Shpenzimet e të ardhurave jashtë limitit	-	3.950	-
4.	GJITHSEJ	14.820.268	3.011.808	20.3

In 000 ALL (Burimi: Ministria e Financave (2016))

Siç evidentohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet korrente përbëjnë rreth 93.4% të fondeve totale të planifikuara, ndërsa investimet janë në 6.6% të buxhetit. Për më tepër rreth 77.3% e fondeve buxhetore të destinuar për vitin 2016 për Ministrinë e Brendshme janë planifikuar të shpenzohen për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve të Policisë së Shtetit. Kostot e personelit përbëjnë rreth 96% të shpenzimeve aktuale, ndërsa shpenzimet kapitale paraqesin një realizim me vlerë shumë të ulët, në vetëm 4% të shpenzimeve. Këtu mund të arrihet në një përfundim paraprak në lidhje me ritmin e ngadaltë të shpenzimeve kapitale si rezultat i vonësve dhe procedurave të prokurimit.

Në lidhje me produktet e investimeve, nuk janë zbatuar ende disa procedura për prokurimin e materiale dhe shërbimeve të përgjithshme për zyra, blerje uniforme, kancelari dhe shërbimi i ushqimit, etj. Për shkak të fondeve të paprokuruara për ndërtimin e mjediseve të Repartit “RENEA”, mund të vihen re investime të perealizuara.



Shpërdorimi i Prokurimeve Publike

Prokurimi publik konsiderohet si pjesë përbërëse e menaxhimit strategjik të fondeve publike për të promovuar përdorimin e kujdesshëm të fondeve si dhe për të ndihmuar në parandalimin e korrupsionit, një dukuri që është mjaft përhapur në Policinë e Shtetit. Duke iu referuar Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit 2015,⁹⁷ të hartuar nga Transparency International Albania, policia rrugore konsiderohet nga shqiptarët si institucioni më i korruptuar.

Në anën tjetër, prokurimi publik është një aspekt kyç i investimeve publike, sepse nxit zhvillimin ekonomik. Më shumë se 22% të buxhetit të shtetit shqiptar i kushtohet prokurimeve publike⁹⁸. Ky tregues riafirmon potencialin e prokurimit publik si një promotor kyç i investimeve si dhe i rritjes ekonomike në të gjithë shoqërinë shqiptare. Kështu, procedura efektive e prokurimit publik përbën një fushë të rëndësishme për zhvillimin e duhur të sektorit të policisë në Shqipëri.

Prokurimi publik për administratën e Policisë së Shtetit gjatë viteve të fundit ka qenë gjithmonë në qendër të debateve të ashpra dhe akuzave të ndërsjella mes partive politike gjatë dhe pas procesit të prokurimit. Një pjesë e kritikës lidhet kryesisht me proceset e prokurimit, buxhetit të nevojshëm, përzgjedhjen e kontraktuesit si dhe me cilësinë e produkteve/shërbimeve të blera. Për më tepër, ky debat i nxehtë pasohet nga hetime penale për shumë raste të procedurave të prokurimit publik.

Specifikimet teknike së bashku me menaxhimin e kontratave⁹⁹ mbeten temat më të vështira për sa i përket kapacitetit të Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, siç tregohet më sipër në seksionin e ekzekutimit të buxhetit, menaxhimi i prokurimit publik përbën një sfidë të madhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe për Policinë e Shtetit. Vonesat në realizimin e procedurave të tenderimit kanë kufizuar realizimin e investimeve të parashikuara në buxhetin e shtetit.

Auditi i Brendshëm

Njësia e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Njësia e Auditit të Brendshëm kishte planifikuar për të kryer 27 audite gjatë 2015, por që kishte bërë vetëm 20 të tilla. Njësia e Auditimit të Brendshëm shmangu kryerjen

97 30% e popullsisë beson se policia rrugore është institucioni më i korruptuar në Shqipëri.

98 Sipas të dhënave që gjenden në adresën në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Ministrisë së Financave.

99 Informacioni u siguroi nga takimi me përfaqësues të institucioneve publike të kryera në 22 shtator 2016.



e auditimit të Drejtorisë Qendrore të Prokurimit në Ministrinë e Brendshme. Kjo drejtori është një njësi kryesore shpenzuese e fondeve buxhetore. Shmangia e auditimit në drejtorinë qendrore të prokurimit tregoi qartë dobësinë e auditimit të brendshëm si dhe përbën shkelje të ligjit të auditimit.

Për më tepër gjatë vitit 2015 njësi pati 15 mbivendosje auditimi me njësitë e auditit të brendshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë. Për më tepër, nga raportet e auditit të realizuara mund të konstatohen mangësi në lidhje me zbatimin e standardeve të auditimit të brendshëm. Në pjesën më të madhe të rasteve del shumë qartë në pah paaftësia e stafit të auditit të brendshëm duke përcaktuar masat disiplinore ndërkohë që nevojitet përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Auditi i Jashtëm

Kontrolli i Lartë i Shtetit është një institucion i pavarur kushtetues i projektuar si “agjent” i Kuvendit dhe si kujdestar i parave publike. Misioni i KLSH-së nuk kufizohet vetëm me raportimin e përdorimit të parave publike në përputhje me ligjin, por duke qenë një organ profesional ai ofron opinione për mundësitë për përdorimin e fondeve në mënyrën më të mirë të mundshme. Misioni i përgjithshëm i KLSH-së është rritja e rolit dhe kontributit në drejtim të mirëadministrimit të financave publike, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve cilësore dhe raportimit mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha burimeve financiare shtetërore, në të mirë të shtetit dhe publikut në tërësi duke përmirësuar kështu qeverisjen.

Prandaj, Kontrolli i Lartë i Shtetit luan një rol të rëndësishëm për mbikëqyrjen dhe parandalimin e abuzimeve me fondet publike. Në këtë aspekt, është nevojë urgjente forcimi i kapaciteteve të KLSH-së për të prezantuar mënyra dhe metodologji të reja në luftën kundër korrupsionit dhe mashtrimit. Aktualisht, KLSH kryen të gjitha llojet e auditimeve, por në përgjithësi ky institucion kryen audite për rregullshmërinë/respektimin e ligjit duke përcaktuar dëmin ekonomik dhe shkeljet e ligjeve në fuqi dhe jo në parandalimin e dëmeve të tilla. Në vitin 2016 parashikohen të bëhen rreth 90% e auditimeve¹⁰⁰ për rregullsinë/përputhshmërinë me ligjin. Ndërkohë, auditimet e performancës të prezantuara që në vitin 2008 nuk janë ende praktikë e rregullt e auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Pavarësia funksionale, operacionale dhe financiare e Kontrollit të Lartë të Shtetit përcaktohet në Kushtetutë dhe në kuadrin ligjor, në përputhje me standardet INTOSAI. Për më tepër, në vitin 2014 Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin i ri Nr. 154 “Për or-

100 Bazuar në të dhënat e disponueshme në Programin e Auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2016.



ganizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Sa i përket kapaciteteve institucionale, në vitin 2015, KLSH kishte 125 auditorë nga rreth 170 të punësuar, në krahasim me 119 në 2014 dhe 113 në vitin 2013. Çdo vit Kryetari i KLSH-së paraqet dy raporte në Kuvend : një raport të aktivitetit në pranverë dhe një raport për zbatimin e buxhetit në vjeshtë. Formatit i raportimit dhe informacioni janë përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme që nga viti 2008. Raportet përmbajnë informacione për shkeljet financiare që evidentohen nga kontrollet që iu bëhen institucioneve të sigurisë si dhe sanksionet apo rekomandimet përkatëse që KLSH propozon për çdo rast.

Komisioni parlamentar për Ekonominë dhe Financat, si dhe Komisioni për Sigurinë Kombëtare janë përgjegjës për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së për sektorin e sigurisë. Megjithatë, nuk kemi ende një përfshirje aktive të të dy komisioneve në shqyrtimin dhe trajtimin e raporteve. KLSH ka të drejtë të ketë akses tek të gjitha informacionet që i gjykon të nevojshme më qëllim kryerjen e detyrave të ngarkuara. Përveç kësaj, KLSH ka autoritetin për t'i drejtuar pyetje punonjësve dhe për të pasur akses në mjediset e nevojshme gjatë kryerjes së aktiviteteve të auditimit. Për të mbrojtur informacionin e klasifikuar ligji parashikon që aktivitetet financiare, të cilat klasifikohen si sekret shtetëror, të kontrollohen vetëm nga personeli i autorizuar nga Kryetari¹⁰¹ i KLSH, i cili nga ana e tij i raporton gjetjet para Komisionit të përhershëm të Ekonomisë dhe Financave.

Ndikimi i punës së auditimit është ende i kufizuar duke qenë se ai përqendrohet në kontrollet për zbatimin e ligjit dhe zbulimin e shkeljeve. Në vitin 2015, KLSH kreu 158 kontrolle¹⁰², zbuloi parregullsi dhe shkelje dëmi financiar i të cilave arrinte në 919,9 milionë euro, ku gjysma e tyre kishte të bënte me auditimin e operatorit shtetëror të shpërndarjes së energjisë elektrike. Kjo përfaqëson një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2014, kur u zbuluan parregullsi shifra e të cilave arrinte në 87.5 milion euro¹⁰³. KLSH kallëzoi 51 raste në Prokurorinë e Përgjithshme për 159 zyrtarë (prej të cilëve 56 ishin zyrtarë të lartë), në krahasim me 41 raste që kishin të bënin me 149 zyrtarë në vitin 2014¹⁰⁴. Në rekomandimet e KLSH-së përfshihen masa ligjore, administrative e organizative dhe zhdëmtimi i vlerës së dëmit si dhe rekomandime për ndjekje penale. Ministria e Financave hartoi një plan veprimi për të trajtuar gjetjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Nga 2510 rekomandime organizative të KLSH-së në vitin 2015, 817 u zbatuan plotësisht dhe 335 u zbatuan pjesërisht¹⁰⁵. U zbatuan edhe gjysma

101 A. Dyrmishi; B. Kuçi, E. Gjokutaj; Vlerësim i rolit të organeve të pavarura të mbikëqyrjes në reformën e sektorit të sigurisë në Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

102 Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf.

103 Ibid.

104 Ibid.

105 Ibid.



e masave administrative dhe disiplinore. Raportet e auditimit përmbliohen çdo tremujor dhe botohen rregullisht në faqen e internetit të KLSH-së. Raporti vjetor i auditit nga KLSH për vitin 2015 u dorëzua në Kuvend, por është ende në fazën e diskutimit.

Nga ana tjetër, roli dhe përfshirja e shoqërisë civile me detyrë monitorimin e menaxhimit financiar, veçanërisht në rastin e Policisë së Shtetit pothuajse mungojnë. Pjesëmarrja e shoqërisë civile patjetër do të përmirësonte dhe lehtësonte punën e KLSH (dhe jo vetëm) në misionin e saj për monitorimin e shpenzimeve të fondeve publike. Po ashtu, shoqëria civile duhet të përfshihet edhe në procesin e raportimit dhe seancave dëgjimore në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave. Aktualisht përfshirja e shoqërisë civile në këto procese nuk është zhvilluar më tej.

Rekomandimet

- ▶ Rritja e transparencës në lidhje me statusin e menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe të auditimit të brendshëm në sektorin e Policisë së Shtetit.
- ▶ Ekzekutimi i buxhetit dëmtohet nga performanca e ulët e investimeve, prandaj duhet të përmirësohen kapacitetet e planifikimit si dhe të sigurohet zbatimi në kohë i procedurave të prokurimit.
- ▶ Staf i auditit të brendshëm ka mungesë kapacitetesh; angazhimet e auditit nuk bazohen tek evidentimi i mangësive të rrezikshme në sistem; kontrollet e kryera nga njësitë e auditit të brendshëm pranë Policisë së Shtetit bëhen ende për transaksionet dhe jo për të gjithë sistemin.
- ▶ Duhet të shmanget mbivendosja e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe e shërbimeve të auditit të brendshëm mes institucioneve eprore dhe vartëse.
- ▶ Duhet të nxitet intensifikimi i marrëdhënieve me Komisionin Parlamentar për Ekonominë dhe Financat për audite specifike të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Përfshirja dhe angazhimi i Kuvendit në shqyrtimin e auditeve të caktuara duhet të trajtohen në një periudhë afatshkurtër.
- ▶ Trajtimi sistematik parlamentar për raportet e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit duhet të bëhet vazhdimisht.
- ▶ Duhet të zhvillohet partneriteti dinamik mes KLSH-së, Kuvendit dhe shoqërisë civile me qëllim sigurimin e menaxhimit ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve publike.



NDJEKJA PENALE

Një rëndësi të madhe në ndjekjen penale luajnë koordinimi dhe veprimet e vazhdueshme të të gjitha organeve shtetërore. Duke qenë se hetimi i korrupsionit mund të nxitet nga një sërë burimesh informacioni, koordinimi i të gjithë aktorëve merr një rol vendimtar. Raportet nga Kontrollit i Lartë i Shtetit, informacioni nga njësitë e auditit të brendshëm dhe nga shërbimet e inteligjencës përbëjnë po ashtu burime të dobishme informacioni. Nga ana tjetër, edhe mediat dhe denoncimet nga publiku janë mjete të dobishme për të ndihmuar në nisjen e hetimeve. Shqipëria ka hartuar tashmë kuadrin ligjor kombëtar për mbrojtjen e informatorëve/sinjalizuesve.

Ligji në fjalë nxit pjesëmarrjen aktive të punonjësve të institucioneve publike apo subjekteve private për të raportuar dhe për të denoncuar aktet dhe praktikat korruptive. Për më tepër, është miratuar edhe ligji për krijimin e një organi të specializuar dhe të pavarur kundër korrupsionit. Ligji rriti aksesin e prokurorëve dhe policisë tek regjistrat publikë kombëtarë elektronikë duke përmirësuar kështu luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, korrupsioni mbetet ende i përhapur në shumë fusha dhe vazhdon të jetë një problem serioz.

Për sa i përket legjislacionit për përgjimet dhe mbikëqyrjen, nuk janë bërë përmirësimet për afatet kohore për hetimet dhe pranueshmërinë e provave para gjykatës. Prandaj, në një periudhë afatshkurtër duhet të ndërmerren ndryshimet në legjislacionin për përgjimet dhe mbikëqyrjen, afatet kohore për hetimet dhe pranueshmërinë e provave para gjykatave në legjislacionin shqiptar.

Pavarësia dhe efektiviteti i institucioneve të ngarkuara me luftën kundër korrupsionit pengohen ende nga presioni politik dhe kapacitetet e dobëta administrative. Sfidë e vazhdueshme për Shqipërinë mbeten rezultatet e qëndrueshme të hetimeve dhe të ndjekjeve penale si dhe dënimet në të gjitha nivelet në luftën kundër korrupsionit, përfshirë këtu konfiskimin e pasurisë së vënë në mënyrë të paligjshme.

Për më tepër, mbeten ende sfidë për autoritetet shqiptare ndërmarrja e hetimeve të qëndrueshme dhe ndjekje penale e rasteve të referuara në prokurori nga organe të tjera shtetërore. Kjo nxjerr në pah një bashkëpunim të dobët ndërinstytucional dhe shkëmbim të pamjaftueshëm të informacionit, gjë që pengojnë hetimet proaktive dhe efektivitetin e korrupsionit. Hetimet financiare që rezultojnë në konfiskim të pasurive numërohen me gishtat e njëres dorë. Gjambat e vendosura në rastet e korrupsionit priren të jenë tepër të buta.



Megjithatë, ia vlen të përmendet se rezultatet e qëndrueshme që nga viti 2010 ka qenë një trend pozitiv për sa i përket numrit të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit ku përfshihen zyrtarë të rangut të ulët apo të mesëm. Rezultatet e qëndrueshme mbeten të pakta sidomos në lidhje me rastet e korrupsionit ku përfshihen zyrtarë të nivelit të lartë. Institucionet përgjegjëse për hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e korrupsionit janë të gjitha subjekt i presionit të fortë politik, përfshirë këtu emërimet e politizuara në poste kyçe të udhëheqjes që ndikojnë në funksionimin e të gjithë sistemit .

Ecuria në karrierë nuk bazohet në merita dhe të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit janë mes institucioneve publike me mangësi të theksuar burimesh. Kështu, vetëm një nga pesë drejtorët e Policisë së Shtetit në 13 vitet e fundit ka mundur të arrijë drejt përfundimit të mandatit të tij të rregullt pesëvjeçar. Lëvizjet në Policinë e Shtetit janë të shpeshta, sidomos pas ndryshimeve të qeverisë. Këshilli i Prokurorëve nuk ka autoritetin e vërtetë për t'i kërkuar llogari Prokurorit të Përgjithshëm , emërimi i të cilit është mjaft i cenueshëm nga politizimi, dhe që kryeson një institucion shumë të centralizuar. Në sistemin gjyqësor, emërimet në Gjykatës së Lartë janë shumë të cenueshme nga politizimi dhe anëtarët e saj nuk japin llogari. Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dominojnë ndikimet e forta politike dhe tarafet . Në këtë aspekt, si Këshilli i Prokurorëve ashtu dhe edhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë dështuar në misionin e tyre për ruajtjen e integritetit e radhëve të tyre. Gjyqtarët, në veçanti, janë bërë në shënjestër për zotërimin e pasurive të pashpjegueshme .


Gjithsesi, reforma në drejtësi që u miratua në Shqipëri në vitin 2016 do të përmirësojë përfundimisht situatën aktuale për sa i përket paanshmërisë dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor, si dhe të institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit. Nga ana tjetër, reforma do të trajtojë edhe pandëshkueshmërinë e veprave penale në Policinë e Shtetit si dhe forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Për më tepër, gjatë vitit 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të ri, Ligjin Nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”. Po ashtu, gjatë këtij viti pranë Prokurorisë u krijua një sektor i ri për verifikimin e integritetit të zyrtarëve publikë. Misioni i këtij sektori bazohet në Vendimin e Kuvendit, Nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zbatimin e ndalimeve të përcaktuara në Ligjin 138/2014 ‘Për garantimin e integritetit të zyrtarëve publikë’”. Ky ligj përcakton prokurorinë si institucionin përgjegjës për verifikimin e integritetit të zyrtarëve në të gjithë administratën publike. Megjithatë efekti i reformës gjyqësore është ende për t'u parë duke qenë se reforma është në punë e sipër.



Niveli i Ndëshkueshmërisë

Siç u theksua edhe më sipër, puna e gjykatave ka rëndësi tepër të madhe për trajtimin e duhur të rasteve të veprave penale. Kështu, në grafikun e mëposhtëm jepen të dhëna për dënimet dhe cilësinë e ndëshkimeve për rastet e hetuara gjatë periudhës 2014-2016. Bazuar tek të dhënat e siguruar nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave janë çuar për ndjekje penale në prokurori 554 dosje në ngarkim të 680 punonjësve të strukturave të policisë. Numri i përgjithshëm i rasteve të shqyrtuara nga Gjykata e Shkallës së Parë për hapësirë kohore në fjalë është: 61 punonjës me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë janë shpallur fajtor dhe dënuar; 22 punonjës, në proces gjykimi në Gjykatën e Shkallës së Parë.

Grafiku 2: Vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë



Këto të dhëna tregojnë qartë se niveli i ulët i ndëshkimit duke iu referuar hetimit penal është i pandryshuar. Në këtë kontekst është me rëndësi të jashtëzakonshme bashkëpunimi më i ngushtë mes organeve të drejtësisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit. Reforma në drejtësi që u miratua në Shqipëri në vitin 2016 do të përmirësojë përfundimisht situatën aktuale për sa i përket paanshmërisë dhe pavarësisë së sistemit gjyqësor si dhe të institucioneve të tjera të zbatimit të ligjit.

Rekomandimet

- Duhet të bëhet transparenca për ankesat ndaj zyrtarëve të policisë. Duhet të publikohen raporte të rregullta në këtë drejtim në faqen e internetit të Policisë së Shtetit.



- ▶ Për shkak të kompleksitetit të hetimit penal në këtë fushë, duhet të krijohen lidhje të forta e të qëndrueshme mes Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë.
- ▶ Duhet të organizohen më shumë trajnime të Policisë së Shtetit për integritetin dhe kodin e etikës.



REFERENCAT

Ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret

- Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, Vendimi nr. datë 26.06.2015
http://www.idp.al/images/informacione/shtyp/New_folder/2016/qershor/MONITORIM_MBI_HARTIMIN_E_PROGRAMIT_TË_TRANSPARENCËS.pdf
http://www.idp.al/images/inspektimi_di/vendim_08_pol.pdf
http://www.idp.al/images/inspektimi_di/vendim_38_dpp.pdf
Kompetencat e komisioneve të përhershme, Vendimi Nr. 95/2014, datë 27.11.2014
Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 62
Kushtetuta e Shqipërisë, Pjesa II, Kreu VI, Neni 60
Kushtetuta e Shqipërisë.
Ligji Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.
Ligji Nr. 70/2014, datë 10.7.2014, “Për Shërbimin e Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme”
Ligji Nr. 108/2014, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”
Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, i ndryshuar.
Ligji Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
Ligji Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Neni 21. <http://idp.al/index.php/en/home/106-press-releases/291-law-no-146-2014-on-notification-and-public-consultation>
Ligji Nr. 155/2014, datë 27.11.2014, “Për Avokatin e Popullit”
Ligji Nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” Neni 5 & 12. <https://www.parliament.al/wp-content/uploads/2016/09/ligj-nr.-19-dt.-22.9.2016.pdf>
Ligji Nr. 44/2014 datë 24.4.2014, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.
Ligji Nr. 45/2014 datë 24.4.2014 “Për Deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” i ndryshuar. &
Ligji Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.
Ligji Nr. 70/2014 “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”
Ligji Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” Kreu III Administrimi i të dhënave personale, <http://www.idp.al/index.php/sq/hetimi-administrativ-mbrojtja-personale-te-dhena?id=130:rekomandime-inspektimi-2010&catid=80>
Ligji Nr. 8454, datë 04.02.1999, plotësuar nga Ligji Nr. 8600, datë 10.04.2000, ndryshuar nga Ligji Nr. 9398, datë 12.05.2005, dhe plotësuar e ndryshuar nga Ligji Nr. 155/2014, datë 27.11.2014, “Për Avokatin e Popullit”.



- Ligji Nr. 9888, date 10.3.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të ndaluarve”, i ndryshuar.
Ligji për Policinë e Shtetit, 2014, Neni 27
- Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë nëpërmjet Buxhetimit, 2011, http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/PARLIAMENTARY-OVERSI-GHT-OF-THE-SECURITY-SECTOR-THROUGH-BUDGETING_June-2011.pdf
- Neni 31/1, Ligji Nr. 120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- Procesverbali i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut 31.05.2016, <https://www.parlament.al/komisioni-per-ceshtjet-ligjore-administraten-publike-dhe-te-drejtat-e-njeriut-shqyrton-projektligjin-per-kontrol-lin-kufitar/>
- Procesverbali i Komisionit për Sigurinë Kombëtare, datë 18.05.2016, <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/06/Komisioni-i-Siguris---dat---18-05-2016.pdf>
- Projektligj “Për masa të tjera shtesë për rendin publik” Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, datë 26.01.2016
- Rregullorja e Brendshme e Kuvendit
- Rregullorja e Policisë së Shtetit, Neni 218
- Seanca dëgjimore me Komisionerin. <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/11/Procesverbal-dat---15.11.2016.pdf>
- Strategjia Për Menaxhimin e Financave Publike 2014 -2020
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 185, datë 25.02.2015, “për Organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 702, datë 26.8.2015, “Për miratimin e Strategjisë së Rendit Publik 2015–2020 dhe të planit të veprimit 2015-2017” Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Nr. 155, 2015 http://www.punetebrendshme.gov.al/files/documents_files/Strategjia_e_Rendit_Publik_2015–2020_dhe_Plani_i_Veprimit_2015–2017.pdf, f. 11154.
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 09.16.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”
- Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 94 Date 15.02.2006 “Për miratimin e rregullores për funksionet”
- Vendimi i Kuvendit Nr. 66/2016, datë 6.10.2016
- Vendimi i Kuvendit, Nr. 211, datë 11.09.2008 “Për Emërimin e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Vendimi Nr. 95/2014, datë 27.11.2014 “Rregullorja e Brendshme e Kuvendit”, i ndryshuar.



Studime, artikuj, raporte

- A. Dyrmishi & E. Hroni, (2014). Conflict of Interest in the Albanian Police. Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/conflict_of_interest_-_cesa_-_english1.pdf
- A. Dyrmishi (2016). “Integriteti dhe Korrupsioni Policor në Shqipëri 2.0” (2016), Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>, f. 35.
- A. Dyrmishi; B. Kuçi, E Gjokutaj: Vlerësim i rolit të organeve të pavarura të mbikëqyrjes në reformën e sektorit të sigurisë në Shqipëri, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
- Buletinet mujore të strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme: <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/programi/buletini-i-mpb-se>
<http://www.gazetadita.al/importi-i-mbetjeve-nis-protesta-para-parlamentit/>
<http://www.oranews.tv/vendi/ndertimi-i-parkut-tek-liqeni-per-plasje-mes-protestuesve-dhe-policise-bashkiake/>
- Indeksi i Hapjes së Parlamentit 2016 – Serbia dhe rajoni: <http://crta.rs/wp-content/uploads/2016/09/ParliamentaryOpennessIndex-1.pdf>
- Intervistë me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Lufta e shqiptarëve kundër drogës: <http://www.balkaninsight.com/en/article/an-albanian-war-on-drugs-11-15-2016> .
- Media dhe sektori i sigurisë: mbikëqyrja dhe përgjegjshmëria Marina Caparini (2004), <http://www.dcaf.ch/Publications/Media-in-Security-and-Governance> , f. 21.
- Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, 2014. http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2015/01/monitoring_and_evaluation_of_security_sector_governance_in_albania_2014.pdf, f. 42.
- Portal online Shqiptarja.com: Vritet efektiv i RENEA-s në Lazarat “Grupi i zjarrit” me 21 persona, <http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/vritet-efektiv-i-renea-s-ne-lazarat---grupi-i-zjarrit-me-21-persona-300972.html>
- Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf, page 8.
- Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf
- Raport mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria në komisaritet e Policisë së Shtetit, në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale dhe në spitalet psikiatrik Korrik 2015 – Janar 2016, <http://www.ahc.org.al/web/images/publikime/al/raport%20te%20drejtat%20e%20njeriut.pdf>, f. 8.
- Raporti i Avokatit të Popullit 2015, f. 47.



- Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë 2016 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2016/20161109_report_albania.pdf, f.18.
- Raporti Vjetor 2015, http://www.idp.al/images/autoriteti/Raporte_Vjetore/Raporti_Vjetor_2015.pdf
- Raporti Vjetor i Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave 2015, <http://shc-ba.gov.al/images/RVP2015.pdf>
- Statistikat nga Stop Korrupsioni <http://stat.stopkorrupsionit.al/department/10>
- Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020, http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/08/Albania_Inter-sectoral_Strategy_against_Corruption_2015-2020_Eng.pdf
- Studimi “Integriteti dhe korrupsioni policor në Shqipëri 2.0” (2016), Institute për Demokraci dhe Ndërmjetësim, <http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/11/Police-Integrity-and-Corruption-in-Albania-2.0.pdf>, f. 42.
- Transparency International “Sistemi Kombëtar i Integritetit (National Integrity System) (NIS)”, 2016, f. 122.
- Transparency International. Albania National Integrity System Assessment 2016. http://files.transparency.org/content/download/2031/13136/file/2016_NISAlbania_SQ.pdf
- UN Women: <http://www.unwomen.org/en/news/stories/2016/7/steering-the-path-to-leadership-for-women-police-officers-in-albania#sthash.qdTAv1k.dpuf>

POINTPULSE

WESTERNBALKANS PULSE FOR POLICE INTEGRITY AND TRUST



WWW.POINTPULSE.NET



twitter.com/POINTPULSEnet



facebook.com/POINTPULSEnet/